



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AKADEMIA E SHKENCAVE**  
Kryesia

**Tryezë e lëndës**  
**Për raportin e veprimtarisë së Akademisë së Shkencave gjatë**  
**vitit 2021 dhe prioritetet e parashikimet për vitin 2022**  
**(Mbështetur në të dhëna statistikore)**

Tiranë, shkurt 2022

# Pjesa I

## Raportimi vjetor 2021

Nr.	Pjesët sipas rendit	Renditja në faqosje
1.	Tryezë e lëndës për raportin e veprimtarisë së Akademisë së Shkencave për vitin 2021	00-Përmbledhëse
2.	Anëtarësimet: anëtarë të Asamblesë, anëtarë të jashtëm, anëtarë nderi (profilet e fituesve); ndryshimet strukturore (njësi të reja të kërkim-studimit)	01-Pranime të reja në Asamble dhe Akademi
3.	Veprimtaria vjetore e njësive dhe qendrave të kërkim-studimit pranë Akademisë së Shkencave	02-Njësitë dhe qendrat
4.	Pasqyrë analitike për konferencat, simpoziumet, seminarët, forumet, workshop-et e organizuara nga Akademia e Shkencave, seksionet, njësitë, komisionet	03-Analitike konferencat etj.

5.	<b>Veprimtaria botuese e Akademisë si ent botues</b>	<b>05-Botimet</b>
6.	<b>Pasqyrë analitike e veprimtarisë së anëtarëve të Asamblesë sipas raportimeve vetjake</b>	<b>06-Analitike – veprimtaria e akademikëve</b>
7.	<b>Pasqyrë përmbledhëse e veprimtarisë së anëtarëve të Asamblesë sipas raportimeve vetjake</b>	<b>07-Përmbledhëse për veprimtarinë vetjake</b>
8.	<b>Çmimi i madh i albanologjisë <i>Meyer-Pedersen-Jokli</i> (konkursi, pjesëmarrësit, të nominuarit, fituesit dhe motivacionet përkatëse)</b>	<b>08-Çmimet</b>
9.	<b>Indeksim, digjitalizim, katalogim, <i>open access</i> (periodikët e Akademisë së Shkencave në komunikim online)</b>	<b>09-Digjitalizimi, indeksimi</b>
10.	<b>Marrëdhëniet me jashtë dhe me institucionet akademike-universitare: marrëveshjet e nënshkruara dhe të përgatitura për nënshkrim</b>	<b>10-Marrëdhënie e marrëveshje</b>
11.	<b>Buxheti: planifikimi, ndryshimet, realizimi</b>	<b>11-Veprimtaria buxhetore</b>
12.	<b>Libri i programeve të veprimtarive të realizuara</b>	<b>12-Libri i programeve</b>

## Pjesa II

### **Prioritetet e veprimtarisë kryesore në nivel institucional, të seksioneve, njësive, qendrave e komisioneve që funksionojnë pranë Akademisë së Shkencave për vitin 2022**

<b>Nr.</b>	<b>Renditur sipas rëndësisë</b>	<b>Renditja për faqosje</b>
	<b>Pasqyrë përmbledhëse për konferencat, simpoziumet, seminarët, forumet dhe veprimtarinë botuese parashikuar për vitin 2022</b>	
<b>1.</b>	<b>Prioritete të veprimtarisë së Akademisë së Shkencave për vitin 2022</b>	<b>00-Prioritete përmbledhëse</b>
<b>2.</b>	<b>50-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit dhe i themelimit të Akademisë së Shkencave</b>	<b>01-Viti i akademizmit</b>
<b>3.</b>	<b>Konferencat e projektet kryesore në nivel institucional, të seksioneve, të njësive, qendrave e komisioneve</b>	<b>02-Konferencat dhe projektet</b>

<b>4.</b>	<b>Veprimtaria botuese: në shtyp dhe të numerizuara</b>	<b>03-Botimet</b>
<b>5.</b>	<b>Botimet promovuese</b>	<b>04-Botimet promovuese</b>

## **Pjesa III**

### **Burimet e raportimit<sup>1</sup>**

<b>Nr.</b>	<b>Titulli i burimit</b>
1.	<b>Raport i veprimtarisë vjetore të SSHSHA për vitin 2021 dhe propozime të seksionit, njësive dhe komisionit për vitin 2022</b>
2.	<b>Raport i veprimtarisë vjetore të SSHTN për vitin 2021 dhe propozime të seksionit, njësive dhe komisionit për vitin 2022</b>
3.	<b>Raport i QBAE për vitin 2021, programi për vitin 2022</b>
4.	<b>Raport i njësive Biotech, NanoAlb, Arkeo-Bylis dhe i njësive të tjera për vitin 2021 dhe projekte e propozime për vitin 2022</b>
5.	<b>Raport për veprimtarinë e <i>Akademisë së të Rinjve</i> për vitin 2021 dhe propozime për vitin 2022</b>
6.	<b>Raport për veprimtarinë kataloguese, digjitalizuese</b>
7.	<b>Raport i veprimtarisë buxhetore</b>

<sup>1</sup> Ruhen në arkivin e institucionit dhe i bashkëngjiten këtij raporti.



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AKADEMIA E SHKENCAVE**  
**Kryesia**

**Pasqyrë përmbledhëse e veprimtarisë së  
Akademisë së Shkencave gjatë vitit 2021**

## I. Anëtarësimet dhe plotësime në strukturë:

Nr.	Të dhëna për pranimet e reja në Asamble e në Akademi dhe për plotësimet në strukturë		
1.	a).	Pranime të anëtarëve të rinj	6
	b).	Avancime në tituj akademikë	-
	c).	Anëtarë nderi - anëtarë të jashtëm	6
	ç).	Pranime të reja të anëtarëve të jashtëm	7
	d).	Pranime të reja për anëtarë nderi	4
	dh).	Ngritje njësisish dhe qendrash të reja kërkimore	6



**II. Veprimtari shkencore në nivel të Akademisë, të seksioneve, njërive dhe të komisioneve të përhershme:**

<b>2.</b>	<b>Veprimtari shkencore, jubilarë dhe përruruesë:</b>		
	<b>a).</b>	<b>Kuvende / kongrese organizuar nga Akademia</b>	<b>2</b>
	<b>b).</b>	<b>Konferenca ndërkombëtare e ndërkademike të organizuara nga Akademia</b>	<b>5</b>
	<b>c).</b>	<b>Konferenca shkencore-jubilarë dhe përruruesë të organizuara prej seksioneve</b>	<b>56</b>
	<b>ç).</b>	<b>Veprimtari shkencore të organizuara prej komisioneve të përhershme</b>	<b>21</b>
		<b>Gjithsej</b>	<b>84</b>

### III. Veprimtari shkencore në nivel të njësive:

3.	<b>Të dhëna sipas njësive</b>		
	a).	Njësia e nanoteknologjisë <i>NanoAlb</i>	21
	b).	Njësia e bioteknologjisë dhe e bioshkencës	5
	c).	Njësia e gjeofizikës dhe sizmologjisë	2
	ç).	Njësia e arkeologjisë së zbatuar <i>Arkeo-Bylis</i>	3
	d).	<p>Njësi të reja të themeluara:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia e studimeve për muzikën <i>Akademia Albanica</i>;</li> <li>-Njësia e arkeologjisë së zbatuar <i>Arkeo-Bylis</i>;</li> <li>- Njësia e kërkim-studimit për arbëreshët, arvanitët dhe arbneshët;</li> <li>- Instituti Kombëtar i Fizikës;</li> <li>- Njësia e kërkim-studimit në fushën e inteligjencës artificiale;</li> <li>- Njësia e kërkim-studimit në fushën e energjive të ripërtëritshme, sistemit elektro-energjetik dhe të efciensës së energjisë.</li> </ul>	6
dh).	Propozim për krijim qendrash kërkimore	1	

#### IV. Projektet kryesore:

4.	<b>Projektet kryesore</b>		
	a).	Për verifikimin serologjik të shkallës së imunitetit të fituar ndaj veprimit të <i>Covid-19</i>	1
	b).	Për kërkimet arkeologjike në Bylis mbi bazën e metodave gjeodezike e gjeofizike	1
	c).	Projekte të njësisë <i>NanoAlb</i>	5
	ç).	Projekte të njësisë <i>Biotech</i>	3
	<b>Gjithsej</b>		<b>10</b>

5.	<b>Projektet madhore të albanologjisë (QBAE)</b>		
	a).	<i>Histori e shqiptarëve (autorë pjesëmarrës)</i>	25
	b).	<i>Fjalor i madh i gjuhës shqipe (autorë dhe bashkëpunëtorë)</i>	65
	c).	<i>Enciklopedia e shqiptarëve (bashkëdrejtues)</i>	2
	<b>Projekte gjithsej</b>		<b>14</b>

## V. Veprimtaria botuese:

### Botime të Akademisë

6.	<b>Përshkrim i kategorive të botimeve</b>		
	a).	Botime shkencore të miratuara nga këshilli i botimeve (nr. titujsh)	36
	b).	Botime me karakter përrues (nr. titujsh)	7
	c).	Botime të numerizuara	2
		<b>Botime gjithsej</b>	<b>45</b>

### Botime jashtë Akademisë dhe kontribute të tjera të akademikëve

7.	<b>Veprimtaria botuese dhe akademike-universitare e anëtarëve të Asamblesë sipas raportimeve vetjake</b>		
	a).	Botime monografike, përmbledhje studimesh, tekste universitare (nr. titujsh)	48
	b).	Artikuj studimorë në revista shkencore	104
	c).	Pjesëmarrje në konferenca shkencore	137
	ç).	Pjesëmarrje në projekte	58
	d).	Veprimtari universitare	76

## VI. Konkursi dhe çmimet:

<b>8.</b>	<b>Tregues të interesimit dhe të pjesëmarrjes</b>	
<b>a).</b>	<b>Çmimi shkencor ndërkombëtar <i>Trinia e Albanologjisë: Meyer-Pedersen-Jokli</i> akorduar për herë të parë</b>	<b>3</b>
	<b>Paraqitën interes</b>	<b>12</b>
	<b>Konkurrues në përputhje me kriteret</b>	<b>8</b>
	<b>Të nominuar</b>	<b>4</b>
	<b>Fitues</b>	<b>3</b>
<b>b).</b>	<b>Çmimi i karrierës - në proces</b>	

## VII. Indeksim-numerizim:

9.	<b>Periodikët</b>		
	a).	Rregullore botimi sipas kërkesave të indeksimit ndërkombëtar	1
	b).	Indeksim në <i>Google Scholar</i> , <i>Doi</i> etj.	2
	c).	Indeksim në proces (për <i>Scopus</i> liste)	1
	c).	Periodikë të numerizuar dhe të paraqitur me <i>open access</i> në platforma ndërkombëtare	8
	ç)	Periodikë të numerizuar dhe të paraqitur me <i>open access</i> në faqen zyrtare të Akademisë	62
10.	<b>Biblioteka shkencore</b>		
	a).	Bibliografite online	2
	b).	Biblioteka shkencore të përfshira rishtas në programin <i>Cobiss-al</i>	17
	c).	Biblioteka shkencore të vendit të përfaqësuar në rrjetin e bibliotekave EIFL (euro-consortium)	30
	ç).	Dhurimet në biblioteka universitare e publike	20
	d).	Baza të dhënash të shtuara (Ecris.al)	1

## VIII. Bashkëpunimi me marrëveshje:

<b>11.</b>	<b>Përshkrim i kategorive të marrëveshjeve</b>		
	<b>a).</b>	<b>Marrëveshjet ndërakademike dhe universitare</b>	<b>13</b>
	<b>b).</b>	<b>Me institucione të tjera brenda vendit</b>	<b>1</b>
	<b>c).</b>	<b>Bashkëpunimi në kuadër të ALLEA-s</b>	<b>2</b>
	<b>ç).</b>	<b>Bashkëpunime të tjera</b>	<b>3</b>
	<b>d).</b>	<b>Marrëveshje të nënshkruara me jashtë</b>	<b>3</b>
	<b>dh).</b>	<b>Marrëveshje me jashtë të negociuara</b>	<b>4</b>
		<b>Të gjitha marrëveshjet dhe protokollet</b>	<b>26</b>

## IX. Buxheti:

12.	Përshkrim i zërave		
	a).	Botimet dhe e drejta e autorit (në mijë lekë)	
b).	Kuvendet dhe kongreset (në mijë lekë)	8.920	
c).	Konferencat në tërësi (në mijë lekë)	9.218	
ç).	Projektet (në mijë lekë)	17.667	
d).	Pagat, sigurimet dhe shpërblimi për titull (në mijë lekë)	56.723	
dh).	Shpenzime operative (qira, ujë, energji etj.) (në mijë lekë)	13.980	
e).	Investime	980	
Buxheti vjetor sipas realizimit			123.988



# **Anëtarësime të reja në Asamble dhe ASH**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
Kryesia

Anëtarë të rinj të asociuar 2021

(sipas nenit 6, 14 e 15 të Ligjit nr.53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” si dhe neni 5 e 7 i Statutit të ASH)

Prof. dr. Rrapo Ormeni

Kandidat për titullin *akademik i asociuar* në gjeofizikë

Rrapo Ormeni është *specialist në fushën e sizmologjisë*, me një veprimtari afro 40 vjeçare në këtë fushë. Pas diplomimit ka kryer specializime *në fushën e analizës së të dhënave sizmike dhe vlerësimin e rrezikut sizmik* në Gjermani e Austri. *Doktor i shkencave në sizmologji* në vitin 2007. Punimet e tij shkencore janë botuar në revista të njohura ndërkombëtare, si *Tektonofizika*. Numri i artikujve shkencorë, monografive dhe përmbledhjeve të studimeve, është mbi 120. Themelimi i lëndëve të reja universitare, si *Fizika e tërmeteve*, bën pjesë në kontributet e tij akademike. Ka profilin dhe autoritetin shkencor të pranuar në rrjetet ndërkombëtare të sizmologjisë. Kontributet origjinale të Rrapo Ormenit lidhen me analizën e aktivitetit sizmik natyror dhe atij të induktuar, si dhe vlerësimin e rrezikut sizmik në vendin tonë. Ka botuar studime të veçanta për rajonalizimin sizmik, mbështetur në regjistrimet e rrjetit sizmologjik shqiptar, ligjësitë në sizmologji dhe metodologjitë bashkëkohore. Ka qenë organizatori kryesor i *konferencës ndërkombëtare për gjeoshkencat dhe inxhinierinë e tërmeteve - sfidat për rajonin e Ballkanit*, e cila u zhvillua në nëntorin e vjetshëm, duke u bërë konferenca e parë në këtë fushëmbas 40 vjetësh në vendin tonë.

Prof. dr. Besnik Baraj

Kandidat për titullin *akademik i asociuar* në shkencat e kimisë

Besnik Baraj është diplomuar për *kimi industriale* në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, fushë në të cilën mbrojti doktoratën dhe fitoi titullin *profesor i asociuar* dhe *profesor*. Është specializuar në Vjenë në *spektroskopinë e plazmës* dhe në Francë (Monaco) për *përcaktimin e metaleve të rëndë në ekosistemet detare me teknika instrumentale*. U përfshi në projekte të rëndësishme industriale menjëherë pas diplomimit: *në prodhimin e ferriteve të butë* dhe *në studimin e mikroelementëve në shëllirat nëntokësore*. Ka marrë pjesë edhe në studimin e pikave të nxehta mjedisore të vendit. Ka përfaqësuar katedrën në projekte shkencore ndërkombëtare, si ai i monitorimit të bregdetit të Mesdheut. Botimet e tij shkencore në revista të njohura ndërkombëtare datojnë në fillim të viteve 1990. *Profesor i ftuar* në universitetin e Barcelonës dhe atë të Rio Grandes (Brazil), me një veprimtari të spikatur *në fushën e kimisë analitike, oqeanografisë dhe ndotjes mjedisore*. Ka 46 artikuj shkencorë të botuar (39 në revista të indeksuara jashtë vendit). Koeficienti i artikujve të botuar prej tij sipas indeksimit në *Scopus-List* është 11. Është bashkautor në tekste universitare të kimisë analitike. Kontributi i tij përfshin zgjerimin e fushave shkencore universitare, drejtimin shkencor të të rinjve, duke udhëhequr mbi 20 teza diplomash të shkallëve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

**Prof. dr. Kozeta Sevrani**

**Kandidate për titullin *akademike e asociuar* në informatikë**

Kozeta Sevrani është diplomuar në Universitetin e Tiranës, ku mbrojti doktoratën në *informatikë të aplikuar*. Profesore në departamentin e statistikës e informatikës së aplikuar (2011). Me kontribute origjinale në krijimin e degës së informatikës ekonomike. Specializimet dhe eksperiencat universitare jashtë vendit: në Norvegji, Suedi, Austri, Spanjë, Zvicër, ShBA, Britani e Madhe, Kinë, Gjermani, Slloveni, Serbi, Greqi e Itali kanë theksuar profesionalizimin e saj si një specialiste në informatikë dhe në sistemet e informacionit. Punimet shkencore të saj janë botuar në revista me emër, si: *Springer, Elsevier, European Journal of Engineering and Technology, Advances in Science, Technology & Innovation*. Një monografi e saj është botuar nga *Springer*. Është hartuese dhe koordinatore e shumë projekteve të mëdha ndërkombëtare dhe organizatore e konferencës së përvitshme ndërkombëtare *Information Systems and Technology Innovation*. Është zgjedhur kryetare e komisionit të promovimit të titujve akademikë. Është anëtare e Federatës Europiane të Simulimeve dhe kryetare e Këshillit të Statistikave të Shqipërisë. Është anëtare e komisionit të matematikë-informatikës dhe e njësisë së inteligjencës artificiale të Akademisë së Shkencave.

Prof. dr. Fatbardh Sallaku

Kandidat për titullin *akademik i asociuar* në shkencat bujqësore

Fatbardh Sallaku është diplomuar si *agronom i përgjithshëm* në Institutin e Lartë Bujqësor, ku filloi menjëherë punë si asistent lektor. Studimet e doktoraturës i mbaroi më 1996. Nga viti 2010 dhe në vazhdim mban titullin *profesor*. Gjatë gjithë karrierës së tij pedagogjike ka ushtruar edhe funksione drejtuese: përgjegjës departamenti, dekan dhe rektor. Ka kryer specializime dhe kërkim shkencor në disa universitete europiane me fokus kryesor studimin dhe analizimin e aspekteve mjedisore që lidhen me tokën, degradimin dhe mbrojtjen e saj, problematikat e zhvillimit rural, politikat agro-mjedisore etj. Ka botuar mbi 60 artikuj shkencorë, nga të cilët 10 në revista shumë të njohura dhe të indeksuara të shkencave bujqësore, si: *Ecology, Environment and Conservation; Research Journal of Agricultural Science; Journal of Ecological Engineering; Journal of Food Agriculture and Environment*. Ka marrë pjesë në shumë kongrese dhe konferenca shkencore ndërkombëtare, si dhe ka qenë organizator i disa prej tyre. Në vitin 2019 ka organizuar e drejtuar konferencën europiane të shkencës së tokës. Bashkëpunon me shumë universitete jashtë vendit, duke udhëhequr, bashkëpunuar ose marrë pjesë në shumë projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Ka veprimtari intensive bashkëpunuese me pjesëmarrjen e tij në projekte të nivelit vendor apo rajonal në bashkëpunim me organizata dhe kompani ndërkombëtare dhe lokale, ku ka kryer shumë ekspertiza në pozicione të ndryshme si drejtues projektesh dhe ekspert ndërkombëtar apo lokal, për çështje të lidhura me politikën e përbashkët bujqësore të BE në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit rural.

Prof. dr. Gëzim Hoxha

Kandidat për titullin *akademik i asociuar* në fushën e arkeologjisë

Gëzim Hoxha është arkeolog në departamentin e antikitetit të vonë dhe mesjetës në Akademinë e Studimeve Albanologjike. Ka 38 vite pune dhe përvojë në kërkimet dhe studimet arkeologjike. Pas përfundimit të studimeve universitare në Tiranë u dërgua për një kualifikim pasuniversitar në Universitetin e Marburg-ut. Fitoi gradën *doktor i shkencave* në vitin 2000 dhe titullin *profesor* në vitin 2009. Ka marrë pjesë dhe ka drejtuar 56 ekspedita dhe *survey*-e arkeologjike. Nga viti 2002 është anëtar korrespondent i Institutit Arkeologjik Gjerman. Pjesëmarrës aktiv në 32 aktivitete ndërkombëtare dhe mbi 50 aktivitete kombëtare për arkeologjinë dhe historinë e vjetër të Shqipërisë. Autor i 9 botimeve monografike apo teksteve. Një monografi me bashkautorësi në proces botimi në Berlin. Autor i 100 artikujve shkencorë, nga të cilët 76 si autor i vetëm. Ka botuar 9 artikuj në gjuhë të huaj. Rreth 30 shkrime të tij janë botuar gjermanisht, frëngjisht, anglisht, italisht e serbokroatisht, disa prej të cilëve në revista arkeologjike prestigjioze në Europë. Gëzim Hoxha është redaktor përgjegjës i revistës *Iliria* (në vitet 2001-2021) dhe përgatitës i botimeve voluminoze me akte të dy aktiviteteve ndërkombëtare në arkeologji. Është mësimpldhënës i arkeologjisë në universitetet Shkodër e Tiranë dhe hartues i 5 programeve arkeologjike. Drejtues shkencor i 10 tezave doktorale.

## Prof. Stefan Çapaliku

### Kandidat për titullin *akademik i asociuar* në fushën e studimeve letrare

Stefan Çapaliku ka studiuar për gjuhë dhe letërsi shqipe në Tiranë dhe ka kryer studime pasuniversitare në Republikën Çeke, Itali dhe Angli. Përfundoi studimet doktorale më 1996 dhe në vitin 2009 mori titullin *profesor*. Mësimdhënës në Universitetin e Shkodrës dhe në Universitetin e Arteve përgjatë 15 vjetëve. Nga viti 2005 dhe në vazhdim është i angazhuar si studiues pranë ASA. Stefan Çapaliku është studiues i letërsisë shqipe dhe shkrimtar i njohur. Ai është marrë me të gjitha periudhat e zhvillimit të letërsisë shqipe. Është autor i veprave monografike në fusha të historishkrimit letrar, estetikës dhe teorisë së letërsisë, midis të cilave: *Fishta satirik*, *Prijës për gjeografinë dhe sociologjinë e letërsisë shqipe*, *Estetika moderne*, *Ars Albanica*, *On Albanian contemporary art*, *Sita estetike*, *Art in post-communist Albania*. Kërkimet shkencore të profesor Stefan Çapalikut dallohen për aplikimin e metodave bashkëkohore të studimit të letërsisë. Ai është autor i 33 librave të botuar në gjuhën shqipe, nga të cilët 16 monografi, studime e tekste universitare. Ka përgatitur e botuar 6 bibliografi vetjake dhe tematike (vepra të plota); nga vepra e tij krijuese 26 tituj janë përkthyer në gjuhë të huaja (italisht, frëngjisht, anglisht, serbokroatisht, turqisht). Ka realizuar 24 kumtime-referate në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, në shqip e gjuhë të huaj. Ka botuar 46 artikuj shkencorë e njhës për historinë e letërsisë shqipe, probleme të periodizimit dhe tipologjisë së dukurive letrare, personalitete të shmangur e të rikthyer; çështje të estetikës dhe teorisë së letërsisë, me fokus të posaçëm shkrimtarët e ndaluar, dramatikën dhe satirën. Ka realizuar 32 premiera si dramaturg dhe disa dhjetëra premiera si regjisor. Për veprën e tij krijuese dhe atë kërkimore janë shkruar 47 artikuj. Fitues i 10 çmimeve dhe mirënjohjeve brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë konkurse kombëtare e ndërkombëtare.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
Kryesia

Anëtarë të jashtëm, 2021

(sipas nenit 6, pika 3 të Ligjit 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 5 e 11 të Statutit të ASH)

1. Prof. dr. Elton Prifti

Prof. dr. Elton Prifti: gjuhëtar, personalitet në fushën e lidhjeve ndërgjuhësore dhe të gjuhësisë krahasimtare; me veprimtari universitare në disa vende europiane (Gjermani, Austri); drejtor i departamentit të gjuhësisë romane, interkulturalitetit dhe multilinguizmit në Universitetin e Vienës; i zgjedhur për herë të dytë (2021) zëvendës-president i Shoqatës Italiane të Gjuhëtarëve; anëtar korrespondent i huaj i Akademisë së Crusca-s, Itali; fitues i çmimit Cesare Pavese; i specializuar për praninë e latinitetit e neolatinitetit në gjuhët e sotme të Europës, duke përfshirë në këtë krahasim shqipen, rumanishten dhe anglishten; autor monografish dhe i dhjetëra artikujve të botuar në revista të mirënjohura gjuhësore për indoeuropeistikë, romanistikë, ballkanistikë, albanologji dhe nënfusha të tjera.

2. Prof. dr. Bardhyl Demiraj

Prof. dr. Bardhyl Demiraj: gjuhëtar, filolog, drejtues i njësisë së shqipes në departamentin e gjuhësisë së përgjithshme dhe të indoeuropeistikës në Universitetin e Mynihut; me veprimtari të gjatë universitare dhe shkencore; autor i vëllimit të shqipes në fjalorin e madh të indoeuropeishtes



*dhe gjuhëve indogjermane* botuar nga ky universitet; organizator konferencash të rëndësishme shkencore ndërkombëtare kushtuar shqipes në kontekst ballkanik, europian dhe indoeuropian; *me një specializim të thelluar në fushën e filologjisë dhe tekstologjisë kritike*; përgatitës e botues i shumë veprave të autorëve të vjetër të letërsisë shqipe; autor i dhjetëra artikujve shkencorë botuar në gjermanisht, italisht, anglisht dhe shqip për çështje të historisë së gjuhës shqipe, të shkrimit të saj, të dëshmimeve të rralla leksikore (fjalë dhe forma) në kontekste aloglote dhe në dorëshkrime arkivore.

### 3. Ermonela Jaho

Ermonela Jaho: soprano shqiptare e renditur në elitën e artistëve lirikë më të shquar të Botës; e vlerësuar si interpretuese virtuozë në kryerole të repertorit të operistikës botërore dhe në skenat e teatrot më të famshëm në Europë dhe në të gjitha kontinentet; fituese e shumë vlerësime dhe çmimeve prestigjioze ndërkombëtare si: çmimi i konkursit *Xhakomo Puçini*; çmimi ndërkombëtar i konkursit *Spontini*; çmimi *The Best Singer* dhe çmimi *International Opera Awards*; e vlerësuar nga mediat më të specializuara botërore si artiste shqiptare që ka arritur nivele më të larta të karrierës artistike.

### 4. Bajram Berisha

Bajram Berisha, profesor me veprimtari mësimdhënëse në Kosovë, Gjermani dhe Shqipëri; *doktor i shkencave* në fushën e gjenetikës së kafshëve në Universitetin e Ljubljanës vijuar me studimet e thelluara në Universitetin Teknik të Mynihut, ku dhe u habilitua si profesor; autor i 74 artikujve shkencorë të botuar shqip, gjermanisht dhe anglisht të indeksuar në *Scopus List*; si dhe i 132 artikujve të kuotuar në *Research Gate*, me mbi 3500 citime, në fushën e fiziologjisë, gjenetikës dhe bioteknologjisë shtazore; me fokus të drejtpërdrejtë në veprimin e faktorve lokalë fiziologjikë; punime që vlerësohen për shtrirjen e fushës së kërkimit në nëndisiplina të reja, që konsiderohen realizime të një rëndësie të veçantë në fushën e shkencave biologjike dhe mjekësore.

## 5. Sokrat Sinaj

Sokrat Sinaj, i titulluar dy herë *profesor i inxhinierisë agrare*, në Shqipëri dhe në Francë; me veprimtari kërkimore dhe mësimdhënëse në Shqipëri, Zvicër e Francë; doktor i shkencave në Institutin Kombëtar Politeknik të Lorenës, vijuar me studime të thelluara postdoktorale në Qendrën Kombëtare Franceze të Kërkimit Shkencor (CNRS); që nga viti 2007 zëvendëskryetar i grupit kërkimor ndërkombëtar për *sistemet e bimësisë natyrore* pranë Institutit Kombëtar Zviceran të Shkencave Bujqësore; është anëtar në disa borde revistash të mirënjohura shkencore ndërkombëtare; autor i 173 artikujve studimorë shqip, gjermanisht dhe anglisht të kuotuar në *Research Gate*, si dhe 78 të indeksuar në *Scopus List* me 3100 citime; drejtues projektsh në disa fusha të ngushta dhe nëndisiplinore.

## 1. Kujtim Shala

Kujtim Shala, profesor i historisë dhe teorisë së letërsisë në Universitetin e Prishtinës, ku përfundoi studimet dhe mbrojtjen e gradës *doktor i shkencave*; studime të thelluara në teori letërsie dhe estetikë të modernizmit në Universitetin e Bolonjës; ligjërues në Universitetin e Prishtinës; anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës; autor i mbi 35 veprave shkencore, eseistike dhe letrare të botuara në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut; si dhe i mbi 50 artikujve shkencorë; fitues çmimesh dhe mirënjohjesh kombëtare e ndërkombëtare për studime dhe letërsi; veprimtar politik dhe qytetar i njohur në Kosovë.

## 2. Fetah Podvorica

Fetah Podvorica, profesor në Universitetin Paris-7, ku mbrojtí gradën *doktor i shkencave* në fushën e elektrokimisë; studime të thelluara në *Ecole Supérieure de Physique et de Chimie de Paris*, ku dhe fitoi habilitimin si profesor universiteti; *profesor i ftuar* në disa universitete jashtë Kosovës, si në Francë, Gjermani e Danimarkë; autor i dy patentave në fushën e veshjes së metaleve, që shfrytëzohen në Europë, SHBA dhe Kinë; anëtar i Shoqatës Amerikane të Kimisë dhe i Shoqatës Ndërkombëtare të Elektrokimisë; ekspert i vlerësimeve të eksterioziuara të studimeve doktorale të fushjës në disa vende të Europës; anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës; anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
Kryesia

**Anëtarë të jashtëm**

**(Sipas nenit 6, pika 3 e Ligjit 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 5 e 11 të Statutit të ASH)**

**1. Luan Starova**

**Akad. Luan Starova, profesor i letërsisë së krahasuar në Universitetin e Shkupit dhe ligjërues në disa universitete të tjera; doktor i shkencave në Universitetin e Sorbonës; studiues, akademik dhe diplomat; anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut dhe nënkryetar i mëparshëm i saj; anëtar i Akademisë Mesdhetare të Italisë; me veprimtari shkencore e krijuese në tri gjuhë krijimtarie: shqip, frëngjisht e maqedonisht; një prej shkrimtarëve shqiptarë më të përkthyer në kohën e sotme; me mbi 150 tituj dhe mbi 300 botime në së paku 15 gjuhë të huaja prej vitit 1970 e këndej; fitues çmimesh e mirënjohjesh të rëndësishme ndërkombëtare, duke përfshirë çmimin më të lartë të Francës për merita letrare që mban emrin e shkrimtares akademike Margaret Yourcenar.**

**2. Ali Aliu**

**Akad. Ali Aliu, profesor i historisë së letërsisë në Universitetin e Prishtinës dhe në Universitetin e Tetovës; mbrojti gradën doktor i shkencave në vitin 1974; studiues i njohur i sistemit letrar në gjithë**

hapësirën e shqipes; anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe zëvendëskryetar i mëparshëm i saj; anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut; autor i më shumë se 30 veprave monografike dhe studimeve shkencore në fushë të historisë dhe teorisë së letërsisë botuar e ribotuar në Prishtinë, Tiranë dhe Shkup; disa nga veprat e tij janë përkthyer në maqedonisht, anglisht e bullgarisht; fitues i shumë mirënjohjeve në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, SHBA, duke përfshirë çmimet më të larta për merita letrare në Kosovë e në Maqedoninë e Veriut; *Nder i Kombit*.

### 3. Akad. Rexhep Ismajli

Akad. Rexhep Ismajli, profesor me veprimtari ligjëruese në Universitetin e Mynihut, të Ljubljanes dhe në atë të Prishtinës; i specializuar për gjuhësi të përgjithshme dhe të zbatuar në Paris nën drejtimin e Andre Martinesë; doktor i shkencave në Universitetin e Prishtinës; anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe kryetar i mëparshëm i saj; anëtar i Akademisë Amerikane të Shkencave; anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave dhe të Arteve, anëtar i *Rrjetit Ndërakademik të të Drejtave të Njeriut* me qendër në Nju Jork; autor i mbi 20 veprave monografike shkencore të botuara në Kosovë e Shqipëri dhe i mbi 100 artikujve shkencorë; përkthyes i 6 veprave shkencore dhe i 12 veprave letrare; i njohur për kontributet e tij origjinale në disa fusha gjuhësisë shqiptare, si historia e gjuhës shqipe, tekstet e vjetra të shqipes, dialektologjia, sociolinguistika e gjuhësia e tekstit, marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e Ballkanit; gjuha standarde; historia e formimit dhe e zhvillimit të saj.

### 4. Francesco Altimari

Francesco Altimari, profesor në albanologji në Universitetin e Kalabrisë; i ftuar si ligjërues në Universitetin e Mynihut dhe në atë të të Manhejmit; në Universitetin e Napolit dhe në Universitetin *Cattholica* të Milanos; *doktor honoris causa* në Unversitetin e Tetovës dhe në Universitetin e Gjirokastrës; anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave

dhe Arteve të Kosovës, anëtar i *Shoqatës Italiane të Studiuesve të Europës Juglindore* (AIESE); përgjegjës i departamentit të albanologjisë në Universitetin Kalabrisë dhe zëvendësrektor i tij; me një veprimtari shkencore-kërkimore mbi 40-vjeçare në disa fusha; autor i mbi 25 veprave të botuara italisht dhe shqip; figurë qendrore e dijes në botën arbëreshe; nyje reference midis albanologjisë italiane e europiane me atë shqiptare; studiues i letërsisë, gjuhëtar, etnolog e antropolog; një prej specialistëve më të shquar dhe më të suksesshëm të filologjisë shqipe bashkëkohore; me ndihmesa të jashtëzakonshme për rinjohjen e letërsisë arbëreshe prej fillimeve deri në kohët moderne, i vlerësuar me mirënjohje e çmime shkencore e letrare, *Nder i Kombit*.

## 5. Matteo Mandalà

Matteo Mandalà, profesor, ligjërues i lëndëve të albanologjisë në Universitetin e Palermos dhe përgjegjës i njësisë së saj; gjithashtu dhe në Universitetet italiane të Kalabrisë, Barit, Leçes, Pizës, Mesinës; si dhe në Universitetin e Tiranës, të Tetovës dhe të shumicës së universiteteve shqiptare; anëtar i Këshillit të Profesorëve të Doktoratës Ndërkombëtare për kërkime shkencore në filologji dhe gjuhësi shqiptare; *doctor honoris causa* në Universitetin e Gjirokastrës, Vlorës dhe Tiranës; anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, fitues i çmimeve më të rëndësishme shkencore të konkursve kombëtare; organizator e pjesëmarrës me rol parësor në konferencat shkencore albanologjike në Europë; autor i mbi 100 publikimeve shkencore në arbërisht, shqip, italisht, frëngjisht e anglisht, me rëndësi themelore për historinë, kulturën dhe letërsinë shqiptare; bashkëthemelues i filologjisë moderne shqiptare, *Nder i Kombit*.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE

Tiranë, më \_\_\_ .11.2021

**Profile të shkurtra intelektuale  
për kandidatët për t'u pranuar si *anëtarë nderi***

**1. Sir Noel Malcolm**

Sir Noel Malcolm është *profesor i shquar* britanik në shkencën e historisë europiane të kohës së re, i specializuar në orientalistikë, veçmas për historinë e ish-perandorisë otomane dhe raportet e saj me Ballkanin dhe Europën. Veprat e tij më të rëndësishme që i kanë dhënë njohje ndërkombëtare lidhen me popujt e këtij rajoni dhe veçanërisht shqiptarët.

Sir Noel Malcolm prej më se dy dekadash i është kushtuar historisë së shqiptarëve në Kosovë e në Shqipëri gjatë shekujve XVI-XVII. Veprat themelore të tij në këtë fushë janë: 1. *Kosovo. A short History* (1998) - *Kosova një histori e shkurtër*; 2. *Agents of Empire* (2015) - *Agjentë të Perandorisë*; 3. *Rebels, Believers, Survivors: Studies in the History of the Albanians* (2020) - *Rebelë, besimtarë, mbijetues: studime në historinë e shqiptarëve*. Sir Noel Malcolm është autor i dhjetëra artikujve shkencorë të botuar në revista të mirënjohura dhe në përmbledhje studimesh kushtuar historisë së shqiptarëve, histories së popujve të Ballkanit dhe marrëdhënieve mes tyre. Me veprat e tij, prof. Noel Malcolm ka dhënë një kontribut thelbësor për çmitizimin e historisë, për çmontimin e disa tezave të gabuara mbi të cilat është bazuar shpesh rrëfimi i historisë së vetes dhe tjetrit në historiografitë e vendeve të Ballkanit. Në veprën *Agents of Empire* (2015), *Rebels, Believers, Survivors: Studies in the History of the Albanians*, bazuar në një njohje sovrane të burimeve arkivore, të atyre tregimtare e të literaturës së specializuar, prof. Malcolm jep një kuadër impresionues të historisë së botës adriatiko-mesdhetare e të mbarë

Europës së shek. XVI-XVII duke ndjekur fatet e anëtarëve të familjes shqiptare *Bruni* nga Ulqini, nga e cila dolën luftëtarë, intelektualë, klerikë e diplomatë të shquar e të vlerësuar sa në oborret Europës, aq edhe në perandorinë lindore të sulltanëve. Analizat e prof. Malcolm janë gjithëpërfshirëse, duke u dhënë vendin e duhur faktorëve politikë, ushtarakë, socialë, ideologjikë e kulturorë, të cilët, të gjithë së bashku, lëvizin përpara procesin historik.

## 2. Brian D. Joseph

Brian D. Joseph është gjuhëtar i njohur amerikan, me kontribute të vlerësuara botërisht në studimet indoeuropeistike, ballkanologjike, helenistike dhe albanologjike. Mban titullin *profesor i shquar* dhe njihet për sukseset e tij shkencore në gjuhësinë krahasimtare dhe në tudimin e dialekteve, ku shqipja ka zënë gjithnjë e më shumë vend me rëndësi. Duke zbatuar metodat moderne të kërkimit shkencor ai i ka lartësuar cilësisht këto disiplina. Prof. Brian D Joseph ka arritur të ndriçojë anë të padukshme të ndryshimit dhe evolucionit gjuhësor, si dhe të teorisë së morfologjisë. Duke gërshetuar hulumtimin akademik me kërkimin në terren, Brian D. Joseph ka zbuluar anë të panjohura të ndërveprimit të gjuhëve në kufi dhe të rolit të kontaktit ndërgjuhësor në kontekstin e marrëdhënieve të gjithanshme të shqiptarëve me popujt e tjerë të Ballkanit. Si vazhdues i traditës më të mirë amerikane të studimeve shqiptare, ai e ka ndikuar për të nxitur dhe vendosur lidhje të qëndrueshme ndër-albanologjike. Shqipja në kontekst të gjuhëve indoeuropiane; shqipja dhe lidhja gjuhësore ballkanike; shqipja dhe gjuhët me ndikim për shkak të fqinjësisë historike; dialektet e shqipes; shqipja në studime krahasimtare, janë disa nga fushat në të cilat Brian D. Joseph shquhet si kontribues cilësor.

Vetë dhe në bashkëpunim me albanologë, helenistë e indoeuropeistë të shquar ai ka botuar studime të rëndësisë parësore për identitetin, lashtësinë dhe origjinalitetin e gjuhës shqipe, si: *Sintaksa e shqipes*; *Një rikthim tek çështja e origjinës së shqiptarëve*; *Enigma e fjalëzës shqipe "po"*; *Zanoret e mesme supletive në shqip në optikën indoeuropiane dhe ballkanike*; *Shqipja online*; *Etimologjia e prefiksit "stër" të shqipes*). Interesime të rëndësishme për shqipen gjenden edhe në veprat *Manual për gjuhësinë krahasuese dhe historike indoeuropiane*; *Infinitivi në Ballkan në pikëpamjen sinkronike dhe diakronike*; *Gjuhët ballkanike* etj.



### 3. José Manuel Floristán Imizcoz

José Manuel Floristán Imizcoz është historian spanjoll i Mesjetës, përfaqësues i një brezi të ri studiuesish europianë që i janë kushtuar epokës së ndritur të Renesancës dhe shekujve të humanizmit. Studimet e tij kanë ndriçuar çështje origjinale të marrëdhënieve midis mbretërive europiane dhe ish-perandorisë otomane.

Profesor Floristán prej më se tri dekadash i është kushtuar dhe përkushtuar studimit të historisë shqiptare në epokën e qendresës arbërore kundër invazionit otoman që kishte tronditur gjithë kontinentin. Studimet e tij, të mbështetura në burime dokumentare që ai vetë i ka zbuluar në arkivat e Spanjës e të Vatikanit, hedhin dritë mbi figurën e Gjergj Kastriotit dhe rolin e tij në mbrojtje të vendit të vet e të qytetërimit europian. Në mënyrë të veçantë ai ka realizuar studime cilësore për interesimin dhe mbështetjen që monarkia spanjolle, sunduese edhe në mbretërinë e Napolit, ofroi për për lëvizjet kryengritëse të shqiptarëve në bregdetin lindor adriatiko-jonian. Studimet e prof. Floristán i kthejnë historisë ngjarje e personazhe përndryshe të panjohur. Ato ndihmojnë të kuptohen proceset historike të zhvilluara në Shqipëri pas epopesë skënderbejane të shek. XV. Këto studime shquhen për mbështetjen në një bazë solide dokumentare e bibliografike dhe në aftësinë për të kryer analiza e përgjithësime, që i hapin rrugë përfundimeve origjinale e me rëndësi në kuptimin e shpjegimin e ngjarjeve historike. Vepra historike e prof. Floristán është gjithashtu produkt i zbatimit të një metode koherente pune, që nis me përcaktimin e një objekti studimi dhe përfundon me analizën e zbërthimin e tij deri në detaj. Mbi 35 artikuj studimorë të tij kushtuar lidhjes së Aragonëve me Kastriotët, interesimeve të mbretërive europiane për qendresën shqiptare, botuar në revistën e mirënjohur *Eritrea*, e prezantojnë atë si një prej medioevistëve më të shquar të sotëm që i janë kushtuar botës shqiptare.

### 4. Leonardo M. Savoia

Është një nga gjuhëtarët italianë më të shquar dhe më prodhimtarë të kohës sonë, me rezultate vendimtare në fushën e studimeve gjuhësore,

vlerësuar me çmime prestigjioze shkencore në Itali dhe në vende të tjera. Profesor, drejtues projektsh shkencore dhe qendrash kërkimore-universitare në nivele të larta, anëtar i Akademisë së mirënjohur *Crusca* dhe president i zgjedhur i Shoqatës Italiane të Gjuhëtarëve; glotolog në formim dhe albanolog në përkushtim.

Interesimet e tij për shqipen nisën me emërimin e tij si profesor i rregullt në Universitetin e Kalabrisë, ku ra në kontakt me realitetin shqipfolës të komuniteteve arbëreshe, përvojë që e shoqëroi gjatë gjithë veprimtarisë shkencore në fushën e gjuhësinë së përgjithshme dhe të glotologjisë, në sociolinguistikë e pragmatikë, në morfosintaksë dhe sidomos në dialektologjinë italo-shqiptare. Që prej më shumë se katër dekadash ka studiuar të gjitha variacionet e të folmeve arbëreshe, të cilave u ka kushtuar më shumë se 25 artikuj shkencorë. Çmohen po aq studimet e tij për gjuhët dhe dialektet e hapësirës ballkanike, si: *Pjesorja dhe paskajorja në të folmen dhe Shkodrës; Morfosintaksa e zanoreve jo-aktive në greqisht e shqip* etj. Falë bashkëpunimit me katedrat e albanologjisë të Italisë, prof. Savoia ka ofruar kontributin e tij shkencor me bujari të madhe, si duke marrë pjesë aktive në nismat e seminareve dhe kongreseve, ashtu edhe në aktivitetet e projektet e promovuara dhe të mbështetura nga drejtuesit përkatës.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
Kryesia

## Relacione të veprimtarisë vjetore të njësive dhe qendrave të kërkim-studimit pranë Akademisë së Shkencave

### I. Qendra e botimeve albanologjike dhe enciklopedike


Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe institucione të tjera shkencore vendëse e më gjerë, ndërmorën iniciativën shkencore për hartimin dhe botimin e disa veprave madhore në fushën e albanologjisë, projekte që mbështeten financiarisht nga qeveritë respektive. Më 7 prill 2021 Asambleja e Akademisë miratoi projektin për hartimin e botimin e tri veprave madhore shkencore: *Histori e shqiptarëve*, *Fjalor i madh i gjuhës shqipe* dhe *Enciklopedia shqiptare*. Realizimi i kësaj ndërmarrje të madhe gjithëpërfshirëse multidisiplinare ka vlera dhe rëndësi sa për prurjet më të fundit shkencore dhe novatore që do të sjellin, aq edhe për faktin se ato do të jenë një pasuri në përdorim për botën akademike dhe për publikun shqiptar. Veprat do të jene një sintezë e arritjeve më të spikatura shkencore të fushave që do të trajtojnë në mënyrë specifike. Në to do të pasqyrohet një trashëgimi e konfirmuar shkencërisht dhe bashkë me të gjithë prurjet dhe gjetjet e reja në fushat respektive.

#### A. *Histori e shqiptarëve*:

Gjatë vitit 2021 filloi puna për hartimin e konceptit, përgatitjen, propozimin dhe miratimin e platformave shkencore dhe preventivit për realizimin e këtij projekti në tre vëllime. Me vendimin nr. 54. datë 16.9.2021 të Kryesisë u caktuan përfundimisht drejtuesit e projektit, u identifikua grupi i autorëve, u caktuan drejtuesit e periudhave historike si edhe grupi i redaktorëve. U nënshkruan kontratat përkatëse me autorët. U identifikuan nevojat-bazë për materiale e forca ndihmëse, për të siguruar akses në arkivat e bibliotekat e

specializuara. U përcaktuan kriteret shkencore e teknike, metodologjia, modelet e unifikuara të terminologjisë, gjuhës, të stilit, të paraqitjes së tekstit e të aparatit shkencor. U përcaktuan fazat e ritmet e procesit të realizimit e diskutimit të tekstit. Secili autor paraqiti prospektin e lëndës që ka për të trajtuar si dhe vëllimin e parashikuar të punës së vet. U krijuan standardet për vlerësimin e të drejtave të autorit në proces e në përmblyllje. Në fund të vitit autorët paraqitën një listë të detajuar të punëve përgatitore të kryera (përcaktim i tematikave, burimeve, i literaturës së nevojshme) dhe dorëzuan pjesë të hartuara të tekstit, që përgjithësisht përfaqësojnë një të katërtën ose një të pestën e vëllimit të përgjithshëm të punës së parashikuar.

Struktura definitive e projektit është si vijon:



Mënyra e masa e shpërblimit të autorëve pjesëmarrës në hartimin e veprës u përcaktuan me vendimin nr. 31 datë 15.4.2021. Me vendimin nr. 35 datë 16.9.2021 të Kryesisë u ngrit një nënkomision i zgjeruar për vlerësimin financiar të të drejtave të autorit, për bashkëdrejtuesit e secilit projekt, për drejtuesit e nëngrupeve shkencore dhe anëtarët e tyre. Bazuar në rezultat e pasqyruara nga ky nënkomision, me vendimin nr. 54 datë 16.09.2021, Kryesia përcaktoi masën e pagesave për bashkëdrejtuesit e projekteve, drejtuesit e nëngrupeve dhe anëtarët e nëngrupeve shkencore për një periudhë 21-mujore, sipas kushteve të përcaktuara në kontratat e lidhura midis tyre dhe drejtorit të QBAE-së dhe kancelarit, pas miratimit të tyre nga Kryesia.

Të dhëna buxhetore për projektin <i>Histori e shqiptarëve</i>			
Numri studiuesve	Tarifa e shpërblimit sipas VKA nr. 31 datë 15.4.2021 (për autorët)	Tarifa e shpërblimit sipas VKA nr. 54 datë 16.9.2021 (për drejtuesit)	Shuma
9	-----	686.700	686.700
23	2.965.500	-----	2.965.500
<b>Shuma përgjithshme:</b>			<b>3.652.200</b>

#### **B. Fjalor i madh i gjuhës shqipe:**

Me vendimin nr. 8 datë 2.2.2021 Për përbërjen e grupit të punës për projektin ndërkademiq të “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe” u hodhën bazat për kalimin në fazën realizuese të projektit *Fjalor i madh i gjuhës shqipe*. Nga drejtuesit e projektit u krye plotësimi, sistemimi e redaktimi i variantit të parë të *Projektit të paraqitur dhe të miratuar nga Asambleja*. Ripunimi mbetet një proces i vazhdueshëm, i kushtëzuar nga rikonceptimet e parimeve-bazë, nga mbështetja lëndore që i nevojitet veprës; nga parashikimet ligjore për të drejtën e autorit etj., deri tek *rikonceptimi përfundimtar i redaksisë e i grupit të hartuesve, ngritja e nëngrupeve të punës etj.* Këto i janë paraqitur Kryesisë në formën e parashtresave e udhëzuesve të veçantë. U hartuan katër dokumente të tillë, që lidhen me parimet e hartimit të veprës, me organizmin e punës për krijimin e kartotekës *ad hoc*, duke krijuar nëngrupet e punës. U bë rikonceptimi e konstituimi përfundimtar i redaksisë, i grupit të hartuesve, i bashkëpunëtorëve, i nëngrupeve të punës, i specialistëve konsulentë, i bashkëpunëtorëve dhe i forcave ndihmëse, në marrëveshje me QBAE.

Një nga detyrat kryesore të realizuara gjatë vitit 2021 ishte ngritja e kartotekës së posaçme të *Fjalorit*. Për këtë në fillim u bë organizimi i punës në 11 nëngrupe sipas fushave, duke përfshirë në to drejtuesit e projektit, redaktorët shkencorë, hartuesit, bashkëpunëtorët, si dhe forcat ndihmëse. Detyrë parësore, mbështetur në *projektin përfundimtar dhe në parashtresat e përmendura*, ishte *hartimi i udhëzuesve të punës nga përgjegjësit e nëngrupeve*. U hartuan *dy gjedhe udhëzuesish* (sipas fushës së nëngrupeve që drejtojnë). Pas kësaj, të gjithë drejtuesit e nëngrupeve *hartuan udhëzuesit për fushat përkatëse*, të cilët u redaktuan dhe u miratuan në një mbledhje të posaçme të redaksisë së *Fjalorit*.

Gjatë vitit 2021 nga redaksia janë bërë mbledhje ose diskutime *online* çdo dy muaj, ku janë trajtuar probleme që lidhen me çështje konceptore, me natyrën

e punës në nëngrupe; për metodikën e vjeljeve leksikore; për teknikat e modelet që do të paraqiten pranë redaksisë etj. Gjatë vitit 2021 u organizua puna për krijimin e kartotekës *ad hoc* në tri nivele: a). Niveli i drejtuesve të projektit; b). Niveli i nëngrupeve të punës dhe c). Niveli i forcave ndihmëse (janë skanuar dhe janë kaluar në word dhjetëra mijë faqe, duke përgatitur lëndë për të filluar punën hartuese në vitin 2022). Përveç përgatitjes së pasurisë së kartotekës së leksikut të shqipes për shfrytëzim maksimal (në format të numerizuar), është punuar edhe për kompjuterizimin e fjalëve në regjistrat e kartotekës. U krijuan seksione të veçanta me pasuri leksikore e frazeologjike si *fondi i fjalorëve shpjegues normativë, fondi i fjalorëve tematikë, fondi i fjalorëve dialektorë, fondi i veprave të autorëve* etj.

Struktura definitive e projektit është si vijon:

AKADEMIA E SHKENCËVE QENDRA E DOTIMEVE ALBANOLOGJIKE DHE ENCIKLOPEDIKE Projekti: Fjalori i madh i gjuhës shqipe					
Drejtues Projekt: Akad. <u>Jani Thomaj</u> ; Prof. Dr. <u>Valter Memisha</u>					
NËNGRUPET SIPAS FUSHAVE					
FRAZEOLOGJIA	LEKSIKU DIALEKTOR	TERMINOLOGJIA DHE SHKURTESAT	LEKSIKU I AUTORËVE LETRARE	HUAZIMET LEKSIKORE	TERMAT ME ARSIM, KULTURË, ART E BESIM
<u>Jani Thomaj</u> <u>Ali Jashari</u>  Forcë ndihmëse: <u>Mariola Zepolari</u>	<u>Gjovanni Shkarta</u> <u>Qemal Murati</u> <u>Viktor Bakiliu</u> <u>Neshiq Merkur</u> <u>Petit Zenebi</u> <u>Gezim Guga</u> (arbëreshët) <u>Ismail Durrmishi</u> (RMV) <u>Berton Sulejmani</u> (RMV) <u>Erol Saku</u> (Preshëvi)	<u>Valter Memisha</u> <u>Tonor Plangarica</u> <u>Ali Kume</u> <u>Teuta Toska</u>	<u>Shefqije Islami</u> <u>Artur Lema</u> <u>Bogdan Balu</u> <u>Dhori Qiriaci</u> (Greq) <u>Ali Caka</u> <u>Berton Sulejmani</u> <u>Idriz Motani</u>	<u>Kristina Jorgani</u> <u>Ardian Vehbiu</u> <u>Juliana Kume</u>	<u>Sheval Broka</u> <u>Teuta Toska</u> <u>Albina Jubani</u> <u>Anila Kanani</u> <u>Mimoza Gjakova</u>
KARTOTEKAT E LEKSIKUT TË SHQIPES	LEKSIKU POLITIKO- SHOQËROR, PUBLICISTIKË	SHËNIMET ETIMOLOGJIKE	LEKSIKU HISTORIK	SHPREHJET ME BURIM TË HUAJ DHE PËR KATEGORITË SEMANTIKE (HOMONIMË)	
<u>Valter Memisha</u> (ASA, Shqipëri) <u>Noim Berisha</u> (BAP, Kosovë)	<u>Mico Samara</u> <u>Tonor Plangarica</u> <u>Artur Lema</u> <u>Resul Tolbiç</u> (Engjëllushe) <u>Karal</u>	<u>Sait Mansaku</u> <u>Anila Omari</u> <u>Bardhyl Demiri</u>	<u>Anila Omari</u> <u>Mimoza Pritu</u> <u>Dhori Qiriaci</u>	<u>Ali Jashari</u> <u>Bahjat Kryezi</u>	

Mënyra dhe masa e shpërblimit të autorëve pjesëmarrës në hartimin e *Fjalorit të madh të gjuhës shqipe* bazohet në vendimin nr. 54 datë 16.9.2021, në të cilin Kryesia krijoi referenca për pagesat e bashkëdrejtuesve të projekteve, për drejtuesit e dhe anëtarët e nëngrupeve shkencore për një periudhë 21-mujore; si edhe në vendimin nr. 70 datë 13.12.2021 *Për disa shtesa në vendimin e Kryesisë nr. 54, datë 16.9.2021, për caktimin e drejtuesve të nëngrupeve sipas fushave të projektit “Fjalor i madh i gjuhës shqipe”, si edhe mënyrës së shpërblimit të drejtuesve, anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve.*

Të dhëna buxhetore për projektin <i>Fjalor i madh i gjuhës shqipe</i>			
Numri studiuesve	Tarifa e shpërblimit sipas VKA nr. 70, datë 13.12.2021 (për autorët)	Tarifa e shpërblimit sipas VKA nr. 54 datë 16.9.2021 (për drejtuesit)	Shuma
16	1.113.000		1.113.000
11		981.600	981.600
<b>Shuma përgjithshme:</b>			<b>2.094.600</b>

### **C. Enciklopedia shqiptare:**

Për vitin 2021, puna në këtë projekt rezulton në një fazë më të prapambetur se dy projektet e tjerë. Arsyeja kryesore e moszhvillimit sipas pritshmërisë paraprake është mosarritja deri më tani e një marrëveshjeje ndërqeveritare të premtuar nga dy qeveritë, mbi bazën e propozimit të dy akademive, në Shqipëri e Kosovë. Puna e zhvilluar për këtë projekt gjatë vitit 2021 ka pasur më tepër karakter përgatitor dhe organizativ.

Me vendimin nr. 42 datë 13.12.2019 Kryesia ngriti grupin e punës për konceptimin, përgatitjen, propozimin dhe miratimin e platformës shkencore të *Enciklopedisë shqiptare*. Më pas, me vendimin nr. 54 datë 16.9.2021 *Për caktimin përfundimtar të bashkë drejtuesve të projekteve madhore në albanologji; të drejtuesve të nëngrupeve shkencore sipas periudhave/ fushave përkatëse dhe të anëtarëve të nëngrupeve; të detyrave, përgjegjësive dhe mënyrës së shpërblimit të tyre* u caktuan edhe bashkëdrejtuesit e këtij projekti madhor. Nga ana e tyre u përgatit një platformë definitive dhe preventivi për mbështetjen financiare. Bashkëdrejtuesit konsultuan imtësisht dokumentacionin e ruajtur për një enciklopedi shqiptare, duke filluar prej projektit të vitit 1990 dhe atij të FESH-it (2000), deri tek përvojat me disa fjalorë enciklopedikë dhe enciklopedi, kryesisht rajonale. Kjo punë mundësoi një qasje më të saktë për strukturën e artikujve, stilin etj.; për ndarjen e punëve dhe përqindjen e artikujve që do të mbulohej nga seksionet (redaksitë) e fushave. Përgjatë vitit 2022, do të vazhdohet me punën me faza, sipas parashikimeve dhe pritshmërisë.

Për pjesëmarrësit në këtë projekt janë bërë pagesa në përputhje me vendimin e cituar për mënyrën dhe masën e shpërblimit të bashkëdrejtuesve (VKA nr. 54 datë 16.9.2021). Me këtë akt Kryesia përcaktoi masën e pagesave për bashkëdrejtuesit e projekteve, drejtuesit e nëngrupeve dhe anëtarët e nëngrupeve shkencore për një periudhë 21-mujore.

**Të dhëna buxhetore për projektin**  
***Enciklopedia shqiptare***

<b>Numri studiuesve</b>	<b>Tarifa e shpërblimit sipas VKA nr. 54, datë 19.9.2021 (për drejtuesit)</b>	<b>Shuma</b>
<b>2</b>	<b>217.800</b>	<b>217.800</b>



## II. Njësia e kërkim-studimit *NanoAlb*

### I. Projektet të mbështetura nga Akademia e Shkencave:

Në vitin 2020 Akademia e Shkencave me buxhetin e saj miratoi mbështetje financiare për pesë projekte të njësisë *NanoAlb* për probleme të pandemisë së shkaktuar nga *Covid 19*. Puna eksperimentale kërkimore në laborator është zhvilluar si bashkëpunim i 13 grupeve të njësisë (universitete nga Turqia, Franca, Austria dhe Italia). Janë organizuar dy takime të përgjithshme të *NanoAlb*-it për të raportuar ecurinë e tyre. Tre prej tyre janë mbyllur:

1. *Design and validation of point-of-care immune-sensor for measurements of ferritin blood levels in Covid-19 patients using carbon based electrodes modified with Nanostructures (IMOFERRICEN);*
2. *Starch-based bio-plastics/chemically modified Graphene oxide composites designed as food packaging films with antibacterial properties (BIO-MGO);*
3. *Nanostructured carbon material to design electrochemical sensor (NCMES).*

Dy projektet e tjera janë në fazën përfundimtare:

1. *Nanocoating of cement-based surface with antiviral properties (NanoVir);*
2. *Production of zeolite-incorporated nanofibrous membranes for water filter application (ZEiNANOF).*

### II. Akreditimi i ciklit të dytë të studimeve (master) në nanoshkencë dhe nanoteknologji:

Në vitin 2020 nisën përpjekjet e para për ngritjen dhe organizimin e një masteri shkencor në nanoshkencë dhe nanoteknologji. Grupi i punës, përmes një bashkëpunimi me përfaqësues të tre vendeve shqipfolëse, u mundësua përpilimi i programit të masterit shkencor dhe syllabuseve përkatës. Akademia e Shkencave mbështeti kërkesën për akreditim drejtuar agjencisë për cilësi në arsimin e lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila e formalizoi akreditimin e programit të propozuar.

### III. Memorandumi i mirëkuptimit katërpalësh:

Më 24.3.2021 u nënshkrua memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Institutit të Onkologjisë të Venecias (IOV-IRCCS); Universitetit të Padovës; Institutit Katalan të Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë (ICN2) dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë / *NanoAlb*, me qëllim bashkëpunimin shkencor në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta kërkimore-shkencore, të veprimtarive universitare, duke përfshirë shkëmbimin afatshkurtër e afatgjatë të profesoratit dhe studiuesve, shkëmbimin e kandidatëve për doktoraturë, organizimin e seminareve dhe takimeve shkencore të përbashkëta.

### IV. Edicioni i 21-të i konferencës ndërkombëtare *Trendet në Nanoteknologji (TNT 2021)*

Më 4-8 tetor 2021 u zhvillua në Tiranë konferenca ndërkombëtare *Trendet në Nanoteknologji*. Qëllimi i saj ishte evidentimi i arritjeve më të rëndësishme në nivel botëror në nanoshkencë dhe nanoteknologji; krijimi e mundësive të zhvillimit të politikave kërkimore në këtë fushë dhe vendosja e kontakteve për bashkëpunime të tjera. Ky ndikoi për të promovuar kapacitetin kërkimor-shkencor të Shqipërisë dhe rajoneve shqipfolëse në këtë fushë nëpërmjet njësisë *NanoAlb* si pjesë e Akademisë. Në këtë konferencë morën pjesë dhe paraqitën arritjet e tyre kërkimore shumë prej figurave të shquara në fushën e nanoshkencës dhe nanoteknologjisë nga gjithë bota. Në seancat plenare të saj paraqitën punimet e tyre shkencore 21 kërkues shqiptarë, nga të cilët 19 ishin anëtarë të grupeve kërkimorë-shkencorë të njësisë *NanoAlb*.

Në workshop-in e parë (bashkëpunim ndërmjet Shqipërisë, Çekisë e Spanjës) u mbajtën dy prezantime shkencore nga përfaqësues të *NanoAlb*, ndërsa në workshop-in e dytë (bashkëpunim ndërmjet Shqipërisë, Spanjës dhe Japonisë) u mbajtën tetë prezantime shkencore nga përfaqësues të njësisë kërkimore-shkencore *NanoAlb*. Në konferencë u paraqitën dhe 21 postera nga përfaqësues të njësisë. Akademia e Shkencave vendosi krijimin e komitetit organizues vendës për kongresin ndërkombëtar *Tendencat në nanoteknologji 2020*.

#### V. Workshop-et e organizuar nga njësia *NanoAlb*:

a). Më 16 mars 2021 u mbajt online workshop-i i parë ndërmjet njësisë *NanoAlb* dhe Institutit Kombëtar të Kimisë të Sllovenisë. Në këtë workshop referuan 7 grupe të njësisë *NanoAlb* dhe 5 kërkues nga Instituti Kombëtar të Kimisë.

b). Më 2 korrik u mbajt online workshop-i ndërmjet njësisë *NanoAlb* dhe Universitetit të Bankës Jugore të Londrës (LSBU). Në këtë workshop referuan punimet e tyre kërkimore-shkencore 7 grupe të njësisë *NanoAlb* dhe 4 kërkues shkencorë nga LSBU.

c). Më 2 gusht u mbajt workshop-i me temë *NanoAlb dhe industria e ndërtimit (NanoAlb & Construction Industry)*, ku u shtrua mundësia e bashkëpunimit me dr. Henning Zoz, president i shoqërisë *ZOZ GmbH*, Gjermani, pioniere në zbatimet e nanoteknologjisë në fushë fushën e ndërtimit, inxhinierisë dhe ruajtjes së energjisë.

#### VI. Seminare (webinare) zhvilluar me profesorë dhe kërkues shkencorë të ftuar nga anëtarët e njësisë *NanoAlb*

Gjatë vitit 2021 *NanoAlb* ka zhvilluar 12 webinarë (takime shkencore online), me të ftuar profesorë e kërkues shkencorë nga hapësira mbarëshqiptare, me qëllim njohjen e pjesëtarëve të grupeve të njësisë risitë e kërkimit shkencor.

#### VII. Doktoratura në nanoshkencë:

*NanoAlb* ka krijuar rrjetin e studenteve doktorantë *Quartz*. Misioni i tij është të ofrojë mundësi për zhvillimin e aftësive ndërdisiplinore, forcimin e rrjetit të ndërveprimit dhe përfshirjes aktive të studentëve në kërkimin shkencor, në përputhje me qëllimin e njësisë *NanoAlb*. Takimi i parë i rrjetit u zhvillua me 1 korrik 2021, ku 10 studentët e parë doktorantë shqiptarë të Shqipërisë,

Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës referuan mbi përvojën në kërkim në fushat e nanoshkencës dhe nanoteknologjisë.

#### VIII. Aktivitete të tjera:

Njësia *NanoAlb* ka zhvilluar pesë takime ndërmjet drejtuesve të grupeve.

Njesisë i janë afruar edhe 3 grupe të reja (dy nga Universiteti Bujqësor në Tiranë dhe një nga Uniersiteti i Prishtinës).

Anëtarët e grupeve kërkimore-shkencorë të *NanoAlb*-it kanë marrë pjesë në 5 projekte Erasmus+, 7 projekte COST; 1 projekt Horizon-2020, 5 projekte të mbështetura nga Akademia e Shkencave (të sipërpërmendur), 8 projekte kombëtare, 5 projekte të tjerë. Gjatë këtij viti janë kryer 14 udhëheqje temash doktrature, 56 udhëheqje temash diplome master; janë botuar 73 artikuj shkencorë në revista ndërkombëtare, shumica prej të cilave të indeksuara në *Journal Citations Index* me IF.

U realizua ndërtimi i faqes së internetit të kësaj njësie ([www.nanoalb.al](http://www.nanoalb.al)), vendosja e saj në domain-in e përzgjedhur dhe mirëmbajtja e saj. Kjo faqe interneti synon të promovojë veprimtarinë shkencore të njësisë *NanoAlb*; të krijojë mundësi dhe ura bashkëpunimi shkencor me grupe shkencore të qendrave kërkimore (universitete/institute); si edhe te afrojnë kërkues shkencorë nga e gjithë bota për të kontribuar për Njësinë *NanoAlb*.

*NanoAlb* ka ndërmarrë nismën për *ngritjen e qendrës së ekselencës të nanoshkencës dhe nanoteknologjisë shqiptare* (*NanoAlb*). Grupi drejtues i është drejtuar institucioneve ligjzbatuese në vend e rajon me kërkesën për shprehje interesi dhe mbështetje konkrete. Projekti është i një rëndësie strategjike, sepse do të mbështesë dhe çojë përpara kërkimin shkencor në këtë fushë, si dhe do t'i shërbejë pozicionimit të shkencës shqiptare të të tre vendeve tona në fushën e nanoteknologjisë, si lider në Ballkan.

### III. Njësia e kërkim-studimit në bioteknologji dhe gjenetikë

I. Workshop-i *Prodhimi dhe certifikimi i fidanëve të drurëve frutore autoktonë me metoda të bioteknologjisë - kërkesë urgjente për tregun*, në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe CNR të Italisë (8 shtator). U organizua nga pala shqiptare dhe italiane me specialistë të frutikulturës, fermerë e biznesmenë të prodhimit të fidanëve të specieve drufrutore dhe specialistë të bioteknologjisë bimore. U paraqiten 5 kumtesa nga kërkues e biznesmenë shqiptare dhe 2 kumtesa nga kërkuesit italianë. U parashtrua dhe u diskutua mundësia e realizimit të një projekti në rrjet institucionesh (UBT, FSHN i UT, QTTB, biznesi privat), me koordinator Akademinë e Shkencave, për fillimin e ngritjes së skemës së certifikimit shkencor të fidanëve të drurëve frutorë autoktonë në Shqipëri.

II. Më 20-21 maj u zhvillua konferenca e parë shkencore me temë *Bioteknologjia dhe gjenetika, zhvillimet dhe sfidat e së ardhmes* (BGIC 2021), organizuar nga njësia *Bio-tech*, me bashkëpunimin e disa universiteteve, si dhe të Shoqatës Europiane të Rrjetit Tematik të Bioteknologjisë. Synimi i konferencës ishte vënia në dukje e prioritetëve dhe mundësive ekzistuese në kërkimin shkencor në bioteknologji dhe gjenetikë, nxitja e sfidave të reja me përfshirjen e metodave dhe teknikave bashkëkohore në ndihmë të zgjidhjes së problemeve të ndryshme të ekonomisë, shëndetit publik, prodhimit ushqimor dhe mbrojtjes së mjedisit. Seksione të konferencës: *bioteknologji mjekësore dhe farmaceutike, bioteknologji bimore, gjenetikë e popullatave, bioteknologji ushqimore shtazore dhe mjedisore*. Pati 38 prezantime shkencore e 35 prezantime me postera, me rreth 200 kontribues pjesëmarrës nga 12 vende, si Gjermania, Franca, Italia, Austria, Greqia, Kosova, Maqedonia e Veriut, Holanda, Libani, Egjipti, Emiratet e Bashkuara Arabe.

III. Më 19 nëntor 2021 u zhvillua konferenca ndërkombëtare me temë: *Menaxhimi i burimeve gjenetike bimore e shtazore*, organizuar në bashkëpunim me UBT dhe me UT. Drejtimet kryesore në të cilat u përqëndruan referuesit: taksonomia e integruar dhe barkodimi sipas ADN-së, menaxhimi i burimeve gjenetike bimore, menaxhimi i burimeve gjenetike shtazore dhe atyre ujore. Ndër përfundimet më kryesore të konferencës ishte theksimi i nevojë së rritjes së bashkëpunimit midis institucioneve kombëtare të vendit që në qendër të veprimitarisë së tyre kanë punën për menaxhimin e këtyre burimeve. Konferenca paraqiti rekomandime edhe për politikëbërësit.

IV. Më 2 dhjetor u mbajt simpoziumi shkencor ndërkombëtar *Vreshtaria dhe Verëtaria në hapësirën mbarëshqiptare*, bashkëpunim me ASHAK dhe institucione të tjera. U vijua me *Sfidat e vreshtarisë dhe kultivarëve autoktonë në Shqipëri dhe Kosovë: nga kërkimi shkencor drejt tregut* (më 3 dhjetor) dhe *Verëra shqiptare në zhvillimin e ekonomisë dhe të turizmit kulinar*, përmbyllur me *Ekskursion njohës në venaritet e Rahovecit, Kosovë*. Në të dy veprimtaritë u mbajtën referime për nxitjen e integritetit të dy vendeve në zhvillimet rajonale e botërore të vreshtarisë dhe të prodhimit të verës, si edhe në trendin aktual të rritjes së kërkesës së tregut. Auditori miratoi dhe një

rezolutë me rekomandime për përmirësimin e legjislacionit dhe të rregullave për kultivimin e kultivarëve të hardhisë dhe prodhimin e verës, për përfshirjen e kërkimit shkencor, si komponent kryesor i kultivimit dhe certifikimit të fidanëve të kultivarëve autoktonë në Shqipëri dhe Kosovë dhe për stabilizimin dhe shumimin e stileve të verërave shqiptare, si edhe për konsolidimin e markës shqiptare, në përputhje me kërkesat e tregut të brendshëm dhe të eksportit. U rekomandua ngritja e qendrave kërkimore për vreshtarinë dhe verëtarinë.

V. Me miratimin nga Kryesia dhe nga Asambleja njësia *Bio-tech* u vendos të shndërrohej në *qendër të kërkimeve në bioteknologji e gjenetikë* dhe vazhdon puna përgatitore për ngritjen dhe pajisjen me infrastrukturën e nevojshme të laboratorëve që janë planifikuar të ngrihen pranë kësaj qendre.

VI. Njësia e bioteknologjisë dhe gjenetikës realizoi në 6-mujorin e parë të pandemisë *Studimin seroepidemiologjik të gjëndjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare*. Grupi studimor përbëhet nga 15 bashkëpunëtorë nga institucione të ndryshme shëndetësore e të arsimit të lartë. Faza e parë dhe e dytë e studimit seroepidemiologjik të gjëndjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 u krye në popullatën e qytetit të Tiranës, në vitin 2020 në Tiranë. Ndërsa faza e tretë u krye gjatë vitit 2021 (qershor-korrik) dhe përfshiu dhe qytetin e Beratit. Numri i kampioneve të marra arriti në 1527. Faza e tretë e studimit lejoi të shihet dinamika e zhvillimit në kohë e imunizimit të popullatës dhe mundësoi një parashikim paraprak të kohës së arritjes së imunitetit kolektiv. Këto të dhëna rezultuan të rëndësishme për vendimmarrjen e masave të mëtejshme epidemiologjike, sidomos të vendimeve që kanë të bëjnë me masat shtrënguese të distancimit social. Nga ana tjetër, njohja dinamike e seroprevalencës së antitropave anti-SARS-CoV-2 u vlerësua si mjaft e dobishme dhe për përcaktimin e strategjisë që duhet ndjekur për aplikimin e vaksinës në të ardhmen. Me rezultatet e këtij studimi janë përgatitur dhe dërguar për botim dy artikuj shkencorë: 1. *Rapid increase of SARS-Cov-2 seroprevalence during 2020 pandemic year in the population of Tirana, Albania* (G. Sulçebe, A. Ylli, F. Cenko, M. Kurti-Prifti); 2. *SARS-Cov-2 seroprevalence in July 2021 among an urban Albanian population and factors related to ongoing vaccination campaign* (F. Cenko, A. Ylli, M. Kurti-Prifti, G. Sulçebe). Rezultat për t'u shenjuar është kalimi i laboratorit të imunologjisë në administrim të Akademisë së Shkencave.

### III. Njësia e kërkim-studimit *Arkeo-Bylis*

Njësia kërkimore e përkohshme e arkeologjisë së zbatuar *Arkeo-Bylis* realizoi *kërkimet e para në Bylis mbështetur në metodat gjeofizike në kërkimet arkeologjike* për përcaktimin e zonave me interes arkeologjik, plotësimin e planimetrisë së qytetit në mënyrë joinvazive, si dhe identifikimin e monumenteve të rëndësishëm, që do të jenë objekt i gërmimeve arkeologjike edhe në vitet e ardhëshme. Nga gërmimet u zbulua stera 2300-vjeçare, e cila i përket shekullit III para Krishtit. Stera është e gjatë 50 metra dhe e thellë 8 metra dhe e mbuluar nga një sistem harqesh. Puna mbi këtë vepër të periudhës 2300-

vjeçare, që mbetet më e madhja e Ballkanit antik të asaj periudhe, vazhdoi për rreth dy muaj. Ndërkohë, gjatë gërmimeve kanë dalë në dritë objekte interesante të periudhës romake, siç është një objekt prej bronzi, si dhe forma të përgatitjes së enëve të qelqit. Zbulimi premtton nxjerrjen e të tjerave objekte në dritë. Synimi kryesor i i projektit është zbulimi i objekteve të periudhës romake, pasi zbulime të hershme që janë bërë në Bylis i përkasin periudhës helenistike dhe antikitetit të vonë. Projekti do të zhvillohet në dy faza: faza e parë, dyvjeçare, do të përqëndrohet në sipërfaqet brenda rrethimit të agorasë së qytetit, duke synuar leximin dhe interpretimin e punimeve egzistuese gjeofizike, verifikimin e tyre në zonat me interes arkeologjik, si dhe mbulimin e plotë gjeofizik të sipërfaqeve ende të patrajtuara të agorasë. Si sipërfaqe prioritare do të preferohen hapësirat ende të paeksploruara përpara stoas A dhe në shpinë të arsenalit. Do të jetë me interes një rikthim për të analizuar rezultatet e hartës së gjeofizikëve italianë dhe për të ndjekur rrugën e daljes së ujit nga teatri dhe të grumbullimit të tij në një cisternë të mundshme.

**Të dhëna përmbledhëse për mbështetjen me buxhet të veprimtarisë së njësive të kërkim-studimit**

<b>Nr.</b>	<b>Njësia</b>	<b>Buxheti për projektet (në mijë lekë)</b>
1.	Projekti për verifikimin serologjik të imunitetit të fituar	3.000
2.	Projekti për njësinë e bioteknologjisë dhe gjenetikës	3.336
3.	Projekte të njësisë NanoAlb	4.000
4.	Projekte të njësisë Arkeo-Bylis	1.024
5.	Projektet e mëdha në albanologji (mbështetje logjistike)	3.700
	<b>Gjithsej</b>	<b>15.060</b>



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AKADEMIA E SHKENCAVE**  
Kryesia

**Të dhëna analitike për kuvendet, konferencat,  
simpoziumet dhe workshop-et shkencore organizuar  
gjatë vitit 2021:**

**Tiranë, 2022**

**I. Të dhëna analitike**  
**për Kuvendin Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike**  
**dhe për Kongresin Ndërkombëtar të Nanoteknologjisë**

<b>Nr.</b>	<b>Titulli i veprimtarisë</b>	<b>Paraqitën interes</b>	<b>Kumtues gjithsej</b>	<b>Anëtarë të ASHSH</b>	<b>Shqiptarë</b>	<b>Të huaj</b>
1.	Kuvendi Ndërkombëtar i Studimeve Albanologjike	230	194	20	126	68
2.	Kongresi Ndërkombëtar i Nanoteknologjisë	610	494	3	87	407
-	Dy kongreset së bashku	840	688	23	213	475
-	Kongreset + konferencat	-	1540	84	-	-



## **II. Të dhëna analitike për kuvendet, konferencat, simpoziumet, workshop-et shkencore**

Nr.	Titulli i veprimtarisë	Kumtues gjithsej	Anëtarë të Akademisë
1.	<i>Vepra dhe jeta e akad. Eduard Sulstarovës dhe prof. Betim Muços, simpozium, 15 janar 2021</i>	9	-
2.	<i>“Quo vadis humanitas”, simpozium me shkas libri i famshëm i Erwin Schrödinger-t “Çfarë është jeta?”, 5 shkurt 2021</i>	9	4
3.	<i>Ismail Kadare, shkrimtar shqiptar në letërsinë botërore, konferencë; promovim i botimit I. Kadare në gjuhët e botës, 28.01.2021</i>	2	-
4.	<i>Pandemia dhe rimëkëmbja: strategjitë e përballjes dhe pritshmëritë e zhvillimit, forum shkencor në bashkëpunim me Kuvendin, 09.02.2021</i>	14	4
5.	<i>Të jesh e para në traditë, veprimtari shkencore kushtuar akademikes së parë shqiptare etnologes Andromaqi Gjergji, 11.02.2021</i>	8	-
6.	<i>Veprimtari shkencore në 85-vjetorin e lindjes së akademikut Bahri Beci; promovim i botimit <i>L’union linguistique balkanique à la lumière des données de la langue albanaise</i> 2.03.2021)</i>	2	-
7.	<i>Workshop ndërkombëtar, bashkëpunim i njësisë shqiptare të nanoshkencës dhe nanoteknologjisë (NanoAlb) dhe Institutit Kombëtar të Kimisë, Slloveni, 16 mars 2021</i>	27	2
8.	<i>Mihal Grameno veprimtar e mendimtar (në 150-vjetorin e lindjes), konferencë shkencore në bashkëpunim me Universitetin e Korçës, 19.04.2021</i>	4	2
9.	<i>Forumi tretë shkencor <i>Pandemia e shkaktuar nga Covid-19 dhe përballimi i saj në Shqipëri</i>, 20 prill 2021</i>	6	-

10.	<i>“Orientalisti, gjuhëtari, historiani, përkthyesi Osman Myderrizi, veprimtari shkencore kushtuar studiuesit Osman Myderrizi, me rastin e 130-vjetori të lindjes, 29.04.2021</i>	4	1
11.	<i>Skënder Anamali - një themelues i arkeologjisë shqiptare, veprimtari shkencore, 07.05.2021</i>	4	2
12.	<i>Veprimtari shkencore-përuruese për botimin e partiturës së baletit të parë shqiptar “Halili dhe Hajrija”, në 95-vjetorin e kompozitorit Tish Daija, 14 maj 2021</i>	6	2
13.	<i>Konferenca e parë ndërkombëtare për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjediseve ujore / 1<sup>st</sup> International Conference on Water Environmental Protection and Sustainable Development WEPSD-2021, 17-18 maj 2021</i>	127	2
14.	<i>Bioteknologjia dhe gjenetika zhvillimet dhe sfidat e së ardhmes (BGIC), konferenca e parë shkencore ndërkombëtare (program i detajuar në shtojcë), 20-21 maj 2021</i>	174	2
15.	<i>Veprimtari jubilarë në 150-vjetorin e veprimtares Sevasti Qiriazi, 21.05.2021</i>	3	-
16.	<i>Konferencë shkencore në nderim të 175-vjetorit të lindjes së Naim Frashërit, në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës, Universitetin e Vlorës dhe Kryegjyshitën Botërore Bektashiane, 25-26.05.2021</i>	21	3
17.	<i>100 vjet nga udhëtimi i Justin Godart-it në Shqipëri, konferencë shkencore, 24.05.2021</i>	5	1
18.	<i>Modele matematikore dhe komputacionale për shkencat e jetës, konferencë shkencore, 3-4 qershor 2021</i>	19	-
19.	<i>SmartGrid : nga Gjenerimi tek shpërndarja e energjisë, konferencë shkencore, 16.04.2021</i>	22	2
20.	<i>Akad. Petrit Gaçja - themelues dhe epinom i kardiokirurgjisë shqiptare, konferencë shkencore in memoriam, 29 qershor 2021</i>	10	1

21.	<i>Speciet invazive në ekosistemet ujore dhe efektet e ndryshimeve të klimës / Invasive alien species in aquatic ecosystems and climate change effects, forum shkencor 12 korrik 2021</i>	17	1
22.	<i>Papa Klementi XI dhe Shqipëria, konferencë shkencore në 300-vjetorin e ndarjes nga jeta të papës me origjinë shqiptare të njohur ndryshe si Gjon Françesk Albani, 15.07.2021</i>	7	3
23.	<i>Implemetimi i projekteve “NanoAlb” 2020-2021: projekte në lidhje me COVID-19 dhe fusha të tjera emergjente të aplikimit të nanoteknologjisë, forum shkencor, 22 korrik 2021</i>	6	1
24.	<i>NanoAlb &amp; construction industry; nanotech cooperation opportunities with Zoz GmbH (Germany), konferencë shkencore, 2.8.2021</i>	5	1
25.	<i>Prodhimi dhe certifikimi i fidanave të drurëve frutorë me ane të metodave inovativetë bioteknologjisë molekulare – nevojë urgjente për tregun, workshop shkencor ndërkombëtar, 6 shtator 2021</i>	8	1
26.	<i>Luan Starova - akademiku, shkrimtari i shumëgjuhësisë, konferencë shkencore, 17.09.2021</i>	9	4
27.	<i>Nderimi, mbijetesat dhe rikthimi i Fishtës në tri kohët e letërsisë, konferencë shkencore ad honorem, në 150-vjetorin e At Gjergj Fishtës, në bashkëpunim me Konferencën Ispeshkvnore të Shqipërisë, 23.09.2021</i>	18	5
28.	<i>Personaliteti i Shën Joan Kukuzelit dhe muzika e tij, konferencë dhe veprimtari muzikore, 1.10.2021</i>	5	1
29.	<i>Migjeni dhe Dritëroi - dy shkrimtarë me vështrim nga e ardhmja, konferencë shkencore 13.10.2021</i>	19	2
30.	<i>Zhvillime, organizime dhe perspektiva të fizikës mjekësore në Shqipëri, forum shkencor, 22 tetor 2021</i>	33	2

31.	<i>Resurset gjenetike bimore dhe shtazore, konferencë ndërkombëtare, 19 nëntor 2021</i>	91	3
32.	<i>Energjia në shqipëri - aktualitet dhe perspektivë konferencë shkencore, 22 nëntor 2021</i>	7	4
33.	<i>Vreshtaria dhe verëtaria në hapësirën mbarëshqiptare, simpozium shkencor ndërkombëtar, 2-4 dhjetor 2021</i>	52	1
34.	<i>Qendrat e banuara të Shqipërisë - gjendja dhe e ardhmja, konferencë shkencore në bashkëpunim me Universitetin e Elbasanit, 17 dhjetor 2021</i>	62	-
35.	<i>Workshop vjetor i njësisë NanoAlb (2021): NanoAlb 2021 annual workshop, 17 dhjetor 2021</i>	19	-
36.	<i>100 vjet nga lufta e Dibrës, konferencë shkencore në bashkëpunim me Institutin e Historisë Ushtarake, 20.12.21</i>	19	4
Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve		852	61

### III. Promovime, ligjërata akademike, veprimtari popullarizuese, pjesëmarrje të tjera:

#### I. Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike:

1. Promovim i librit *Ismail Kadare në studimet franceze*, 28 janar;
2. *Ekspozitë fotografike* kushtuar jetës dhe veprës së Ismail Kadaresë, 28 janar;
3. Veprimtari solemne *Të jesh e para në traditë*, kushtuar akademikes së parë shqiptare Andromaqi Gjergji, 11 shkurt;
4. Aktivitet në kuadër të *Ditës Ndërkombëtare të Gjuhëve Amtare*, 21 shkurt;
5. Promovim i botimit *L'union linguistique balkanique à la lumière des données de la langue albanaise* të akad. emeritus Bahri Beci, 2 mars;
6. Promovim i botimit *Pjetër Gaci - kemi muzikën që të mos vdesim*, me autor akad. asoc. Stefan Çapaliku, 31 mars;
8. Promovim i botimit *Fjalor i homonimeve në gjuhën shqipe* nga prof. dr. Ali Jashari, Korçë, 19 prill;
9. Promovim i *Fjalori i gjuhës shqipe* (grup autorësh), Aleksandër Xhuvani – Fjalori i gjuhës shqipe, 20 prill;
10. Ligjërata akademike nga akad. Aurela Anastasi -*Drejtësia kushtetuese dhe ndikimi i saj për gëzimin e të drejtave sociale: një analizë kritike nga vështrimi doktrinar*, 12 maj;
11. Promovim i *Partiturës së baletit të parë shqiptar "Halili dhe Hajrija" e akad. Tish Dajisë (1926-2003)*, 14 maj;
12. *Përrurimi i librit Njerëz me dritë* të Lefter Çipës, Vlorë, 24 maj;
13. Koncert me vepra të kompozitorëve akademikë nga vende të Ballkanit, *Academia Albanica*, 28 maj;

14. Ligjërata akademike nga akad. Anastas Angjeli – *Stategjitë e reja dhe ndryshimet e teorive ekonomike dhe strategjive të zhvillimit ekonomiko-social në peridhën e pandemisë së Covid-19 dhe perspektivat afatgjata të zhvillimit dhe mirëqeverisjes*, 5 korrik;
15. Ligjërata akademike nga akad. asoc Adrian Civici – *Evolucioni dhe ndryshimet strukturore në tregun e punës dhe lindja e profesioneve të reja në periudhën post-covid-19. Si duhet reaguar?*, 5 korrik;
16. Promovim i botimit *Bregu i mërgimit*, i akad. Luan Starovës, 17 shtator;
17. Paradite shkencore kulturore *Joan Kukuzeli dhe dita ndërkombëtare e muzikës*, 1 tetor;
18. Promovim i botimit shqip të tezës së doktoraturës së akad. Dritëro Agollit *Skicat dhe tregimet e shkrimtarit revolucionar shqiptar Migjeni*, 13 tetor;
19. Ekspozitë fotografike me portrete të Dritëroit, punuar nga artistë vendës e të huaj;
20. Tryezë e përbashkët me në fokus librin shkencor të Kosovës, 22 tetor;
21. Promovim i botimit *Banda Kombëtare “Vatra”, një histori unike shqiptaro-amerikane*, të akad. Vasil S. Tole; 5 nëntor;
22. Promovim i botimit të prof. Neritan Cekës *Në fillimet e qytetit ilir*, 17 nëntor;
24. Promovim i botimit *Vendbanime dhe banesa fshatare në Shqipërinë e Veriut*, me autor prof. Pirro Thomon, 18 nëntor;
25. Ligjërata nga autorë të nominuar për çmimin e albanologjisë Mayer-Pedersen Jokl - Noel Malcolm me veprën *Agents of Empire: Knights, Corsairs, Jesuits, and Spies in the Sixteenth-Century Mediterranean World*; David Hosaflook me veprën *Lëvizja Protestante te shqiptarët, 1816-1908 (The Protestant Movement Among the Albanians, 1816-1908)*; Lucia Nadin *Figura e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut (nga historia te miti: shekujt XV-XVIII)*; José Manuel Floristán, me veprën *Himarë-Spain: human and political relations during the 16<sup>th</sup> and 17<sup>th</sup> centuries/ Erytheia*; Dhori Qirjazi me veprën *Thimi Mitko, Fjalëtore Shqip-Gërqisht / Gërqisht-Shqip & ndihmesa të tjera leksikografike*, 27 nëntor;
26. Koncert me vepra të kompozitorëve - akademikë bashkëkohorë, *Academia Albanica*, 27 nëntor.

Nr.	Promovime	Ligjërata	Të tjera	Kontribuues gjithsej
1.	11	6	7	108

## II. Seksioni i Shkencave Teknike dhe Natyrore:

Nr.	Promovime	Ligjërata	Të tjera	Kontribuues gjithsej
1.	2	2	3	32

1. Promovim i librit *Infiniti Blu*, 16 qershor;

2. Promovimi i librit *Flora ekskursioniste*.

1. *Natë astronomie*, 28 qershor;

2. *Paraqitja e rezultateve të projektit mbi seropozitivitetin*, 20 shtator;

1. *Festivali kombëtar i shkencës (në kuadër të projektit Science on Stage)*, 3 prill;

2. *Tryezë e rrumbullakët për Eurokodet*, 22 nëntor;

3. *Ekspozita për Digat e larta në Shqipëri*, 13 dhjetor.

Nr.	Promovime	Ligjërata	Të tjera	Kontribuues gjithsej
I+II	12	8	10	140





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE

**Botimet e vitit 2021**

**I. Me vendim të këshillit botues:**

Nr.	Autori / përgatitësi	Titulli
1.	Aristotel Spiro	<i>Nyjat në gjuhën shqipe: diakronia dhe sinkronia e një evolucioni tipologjik: prokliza binare dhe enkliza shqese</i>
2.	Bahri Beci	<i>Rreth rolit të shqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike</i>
3.	Ethem Likaj	<i>Burimi dhe formimi i dëshirores së shqipes</i>
4.	Aurela Anastasi	<i>Barazia dhe drejtësia gjinore (shkrime dhe analiza juridike)</i>
5.	Gjovalin Shkurtaj	<i>Fjalori leksiko-frazeologjik i Malësisë së Madhe</i>
6.	Vasil S. Tole	<i>Skënderbeu Kryezot (opera, partitura)</i>
7.	Jani Vangjeli	<i>Flora ekskursioniste e Shqipërisë - manual profesional</i>
8.	Tomorr Plangarica	<i>Aspekte të gjuhësisë së zbatuar</i>
9.	Luan Starova	<i>Mërgimi i ngjalave</i>
10.	Shaban Sinani	<i>Shekulli letrar i Kadaresë</i>
11.	Rexhep Ismajli	<i>Drejtshkrimet e shqipes (ribotim i plotësuar)</i>
12.	Jup Kastrati	<i>Faik Konica - jeta dhe veprat (ribotim i plotësuar)</i>
13.	Olgita Ceka	<i>Byllis</i>
14.	Përgatitës: Mehmet Gëzhilli	<i>Naim Frashëri në mendimin kritik të huaj</i>

15.	Pirro Thomo	<i>Vendbanime e banesa fshatare në Shqipërinë e Veriut (ribotim i plotësuar)</i>
16.	Ylli Drishti Andrea Llukani	<i>Arti i ikonografisë në Shqipëri</i>
17.	Përgatitës: Dhori K. Qirjazi	<i>Panajot Kupitori: Fjalori i përkundërt arvanitisht-shqip greqisht<sup>1</sup></i>
18.	Bashkim Kuçuku	<i>Kadare në kritikën botërore, vëll. III</i>
19.	Fatmir Hysi	<i>Rrënjët kristiane të muzikës shqiptare</i>
20.	Përgatitës: Eno Koço, Lorenc Radovani	<i>Fan S. Noli - Vepra muzikore</i>
21.	Apollon Baçe	<i>Arkitektura në Iliri (anglisht)</i>
22.	Përgatitës: Ermal Nurja	<i>Udhërrëfyes i dokumenteve osmanisht në Arkivin e Stambollit për Vlorën</i>
23-24	Marenglen Verli	<i>Shqiptarët përballë sfidave të historisë (studime, referate, kumtesa), vëll. I-II</i>
25-26	Studia Albanica, 1-2, 2020	Kryeredaktor Vasil S. Tole
27-28	Studia Albanica, 1-2, 2021	Kryeredaktor Pëllumb Xhufi
29-30	JNTS 1-2, 2021	Kryeredaktor Neki Frashëri
<b>II. Botime përruese-jubilare</b> (Me vendim të Kryesisë)		
1.	Irakli Koçollari (përg.)	Akte të konferencës për 75-vjetorin e luftës antifashiste
2.	Albert Doja	Naim Frashëri ndërmjet bektashizmit dhe shqiptarësisë

<sup>1</sup> Bartet në listën e botimeve të vitit 2022, për shkak se leja e autorit u mor në fund të muajit shtator. U zëvendësua me vendim qarkullues nga këshilli i botimeve me vëll. II të *Historisë së luftës antifashiste*, autor Paskal Milo.

3.	<b>Apollon Baçe (përkth.)</b>	<b>Arkitektura në Iliri</b>
4.	<b>Dritëro Agolli</b>	<b>Skicat dhe tregimet e shkrimtarit revolucionar shqiptar Migjenit (përg. Sh. Sinani)</b>
5.	<b>Panajot Kupitori</b>	<b>Studime shqiptare (përg. Dhorë K. Qirjazi)</b>
6.	<b>Muhamet Çami</b>	<b>Vepra (financuar nga shoqata <i>Hasan Tahsin</i>)</b>
7.	<b>Proceeding Book</b>	<b>Kuvendi Ndërkombëtar i Studimeve Albanologjike</b>

# **Konkursi dhe çmimet**



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË  
Juria ndërkombëtare e konkursit

Për çmimin  
*Trinia e Albanologjisë: Meyer-Pedersen-Jokli*

Akorduar për veprën shkencore më cilësore në albanologji

**Certifikatë nominimi**

Për veprën *Lëvizja protestante te shqiptarët, 1816-1908*

Autor: David Hosaflook

*Vepër në të cilën për herë të parë, në mënyrë të plotë e të thelluar, mbështetur në burime të panjohura, vlerësohet historia e lëvizjes protestante te shqiptarët në periudhën e Rilindjes Kombëtare; roli i kësaj lëvizjeje për njësimin e shkrimit shqip dhe për inkurajimin e përpjekjeve për emancipimin e gruas shqiptare; libër referencial për mjaft aspekte të historisë politike e kulturore të shqiptarëve, që i shton kësaj historie figura dhe ngjarje historike me gjurmë të pashlyeshme.*

Kryetari i Jurisë

Kryetari i Akademisë së Shkencave

Akad. Pëllumb Xhufi

Akad. Skënder Gjinushi

Nr. \_\_\_\_\_. regj.

Tiranë, më 27.11.2021



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË  
Juria ndërkombëtare e konkursit

**Për çmimin**  
***Trinia e Albanologjisë: Meyer-Pedersen-Jokli***

Akorduar për veprën shkencore më cilësore në albanologji

**Certifikatë nominimi**

**Për veprën *Fjalëtore shqip-gërqisht, gërqisht-shqip të***  
**Thimi Mitkos**

**Përgatiti për botim: Dhori Q. Qirjazi**

*Botim që nxjerr në dritë një monument të shqipes, duke shpëtuar nga harresa e humbja një vepër që konservon një pasuri të rrezikuar të fondit të leksikut të saj historik, realizuar me një punë këmbëngulëse dhe të përkushtuar shumëvjeçare filologjike dhe studimore nga Dhori Q. Qirjazi, i cili ka përballuar me përgjegjësi shkencore vështirësitë e interpretimit të tekstit autograf, të transkriptimit e përpunimit leksikografik, realizuar me akribi dhe kritere shkencore e me nivel të lartë.*

Kryetari i Jurisë

Kryetari i Akademisë së Shkencave

Akad. Pëllumb Xhufi

Akad. Skënder Gjinushi

Nr. \_\_\_\_\_. regj.

Tiranë, më 27.11.2021



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË  
Juria ndërkombëtare e konkursit

**Për çmimin**  
***Trinia e Albanologjisë: Meyer-Pedersen-Jokli***

Akorduar për veprën shkencore më cilësore në albanologji

**Certifikatë nominimi**

***Për veprën Studime për epokën e Gjergj Kastriotit,  
epokën e tij dhe shekujt pasues, si dhe lidhjet me  
mbretëritë europiane***

**Autor: José Manuel Floristán Imizcoz**

*Studime të mbështetura në burime të reja arkivore spanjolle e italiane, që hedhin dritë mbi historinë shqiptare të shekujve XVI-XVII; mbi zgjimin e interesit të monarkisë spanjolle për lëvizjet kryengritëse të shqiptarëve në bregdetin lindor adriatiko-jonian, me rol të rëndësishëm shkencor për të kuptuarit e proceseve historike të zhvilluara në Shqipëri pas epopesë skënderbejane.*

Kryetari i Jurisë

Akad. Pëllumb Xhufi

Kryetari i Akademisë së Shkencave

Akad. Skënder Gjinushi

Nr. \_\_\_\_\_. regj.

Tiranë, më 27.11.2021



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË  
Juria ndërkombëtare e konkursit

Për çmimin  
*Trinia e Albanologjisë: Meyer-Pedersen-Jokli*

Akorduar për veprën shkencore më cilësore në albanologji

**Certifikatë nominimi**

Për veprën *Figura e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut (nga historia te miti: shek. XV-XVIII)*

**Autor: Lucia Nadin**

*Vepër që finalizon një punë të gjatë e të mundimshme, me një analizë në 360 gradë, në kërkim të gjurmëve që lidhin historinë e Shqipërisë me atë të Venedikut, duke pasur në qendër figurën e Gjergj Kastriot-Skënderbeut dhe receiptimin e saj në mjedisin veneto-padovan, mbështetur në dëshmi arkivore, artistike, letrare, historiografike të zbuluara e të vlerësuara drejtpërsëdrejti, që nxjerrin në pah impaktin e jashtëzakonshëm që pati në Venecie dhe në territoret e shtetit të Venedikut figura e heroit të rezistencës arbërore.*

Kryetari i Jurisë

Kryetari i Akademisë së Shkencave

Akad. Pëllumb Xhufi

Akad. Skënder Gjinushi

Nr. \_\_\_\_\_. regj.

Tiranë, më 27.11.2021





AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË  
Juria ndërkombëtare e konkursit

**Për çmimin**  
***Trinia e Albanologjisë: Meyer-Pedersen-Jokli***

Akorduar për veprën shkencore më cilësore në albanologji

**Certifikatë nominimi**

***Për veprën *Rebels, Believers, Survivors: Studies in the History of the Albanians****

**Autor: Sir Noel Malcolm**

*Vepër e bazuar në një njohje sovrane të burimeve arkivore, tregimtare e të literaturës së specializuar, në të cilën, me argumente gjithëpërfshirëse, jepet një kuadër impresionues i historisë së botës adriatiko-mesdhetare e i mbarë Europës së shekujve XVI-XVII, me pikënisje e duke ndjekur fatet e anëtarëve të një familjeje fisnike shqiptare, nga e cila dolën luftëtarë, intelektualë, klerikë e diplomatë të shquar e të vlerësuar sa në oborret e Europës aq edhe në ish-perandorinë otomane.*

Kryetari i Jurisë

Kryetari i Akademisë së Shkencave

Akad. Pëllumb Xhufi

Akad. Skënder Gjinushi

Nr. \_\_\_\_\_. regj.

Tiranë, më 27.11.2021



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË  
Juria ndërkombëtare e konkursit

**Për çmimin**  
***Trinia e Albanologjisë: Meyer-Pedersen-Jokli***

Akorduar për veprën shkencore më cilësore në albanologji

**Certifikatë nominimi**

**Për veprën *Lufta e fshehtë në Shqipëri***

**Autor: Roderick Bailey**

*Libër që pasuron në mënyrë të ndjeshme letërsinë historike mbi Luftën II Botërore në Shqipëri; kontribut cilësor për historiografinë shqiptare; që ofron një panoramë të dokumentuar të veprimtarisë së misioneve ushtarake britanike në Shqipëri; mbështetur në shfrytëzimin e një dokumentacioni të pasur të deklasifikuar së fundi, duke trajtuar me qetësi e objektivitet një moment crucial për historinë e Shqipërisë, që mbetet ende sot me një ndjeshmëri të madhe dhe ka prodhuar me shumicë literaturë me qëndrime të anshme; vepër ku gdhenden në mënyrë të dokumentuar grupimet e ndryshme politike e ushtarake shqiptare dhe marrëdhëniet midis tyre dhe me pushtuesit nga njëra anë dhe me aleatët anglo-amerikanë, nga ana tjetër.*

Kryetari i Jurisë

Kryetari i Akademisë së Shkencave

Akad. Pëllumb Xhufi

Akad. Skënder Gjinushi

Nr. \_\_\_\_ regj.

Tiranë, më 27.11.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
Kryesia

Pasqyrë përmbledhëse e veprimtarisë së bibliotekës  
shkencore (pa botimet)<sup>1</sup>

Nr.	Titulli i veprimtarisë	Nr.
1.	Bibliografi vetjake <i>online</i> të anëtarëve të Akademisë	+ 2
2.	Numra të rinj të periodikëve në <i>open access</i> , duke përfshirë identifikimin elektronik <i>doi</i> ( <i>digital object identified</i> ) dhe indeksimin në <i>Google Scholar</i>	+ 10
3	Rrjete të specializuara të përfshirjes së bibliotekës shkencore për shërbim pa pagesë	9
4.	Marrëveshje të reja ndërkomunikimi në distancë (për bazën e të dhënave <i>Ecris.al</i> ; anëtarësimi në EIFL - <i>Electronic Information for Libraries</i> - me rolin e kryesuesit vendor të konsorciumit të bibliotekave)	+ 2
5.	Numri i bibliotekave shkencore të përfaqësuara në programin evropian katalogimit <i>Cobiss</i>	+ 8
6.	Veprimtari formuese për bibliotekat në rrjetin <i>Cobiss.al</i> (duke përfshirë katalogimin e monografive)	8
7.	Konceptim dhe realizim programesh, ftesash, posterash, banerash; formatim dhe realizim programesh, <i>librash të abstrakteve</i> ( <i>proceeding book</i> ) etj.	48

<sup>1</sup> Për veprimtarinë botuese janë paraqitur të dhëna të statistikuara më vete. Bashkëngjitet raporti vjetor i sektorit të botimeve shkencore dhe bibliotekës.

8.	<b>Dhurime koleksionesh të botimeve akademike bibliotekave shkencore-universitare dhe publike</b>	<b>16</b>						
9.	<table border="1"> <tr> <td colspan="2" data-bbox="316 304 1246 376" style="text-align: center;"><b>Pjesëmarrje në panaire</b></td> <td data-bbox="1246 304 1369 376" style="text-align: center;"><b>2</b></td> </tr> <tr> <td data-bbox="316 376 1042 477" style="text-align: center;"><b>Përurime botimesh në panaire</b></td> <td data-bbox="1042 376 1246 477" style="text-align: center;"><b>5</b></td> <td data-bbox="1246 376 1369 477" style="text-align: center;"><b>5</b></td> </tr> </table>	<b>Pjesëmarrje në panaire</b>		<b>2</b>	<b>Përurime botimesh në panaire</b>	<b>5</b>	<b>5</b>	
<b>Pjesëmarrje në panaire</b>		<b>2</b>						
<b>Përurime botimesh në panaire</b>	<b>5</b>	<b>5</b>						
10.	<b>Bibliografi tematike në shërbim të projekteve të Akademisë (dosja për <i>Motin e Madh</i> në UNESCO etj.)</b>	<b>4</b>						



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AKADEMIA E SHKENCAVE**

**Marrëveshje të propozuara, negociuara dhe nënshkruara  
gjatë vitit 2021**

**I. Marrëveshje ndërakademike ose ndëruniversitare të  
nënshkruara me institucione jashtë vendit:**

1. Marrëveshje me Universitetin Karlovi (*Charles University*), Pragë, në Republikën Çeke: u realizua dhurimi i një koleksioni të botimeve albanologjike;
2. Marrëveshje me Akademinë e Shkencave Bujqësore dhe Pyjore të Rumanisë;
3. Marrëveshje me Universitetin e Padovas (me Institutin Onkologjik Veneto - ICN2);
4. Propozimi dhe pranimi i dy kandidatëve për ekspertizë europiane, bashkëpunim me ALLEA-n;
5. Akreditim i akad. Nazim Grudës si përfaqësues i Akademisë së Shkencave në Akademinë Europiane të Shkencave Bujqësore e Pyjore;
6. Marrëveshje me Universitetin e Prishtinës *Hasan Prishtina*;
7. Marrëveshje me Institutin Albanologjik të Prishtinës.

**II. Marrëveshje ndërakademike ose ndëruniversitare të miratuara  
në parim, të negociuara, në fazë nënshkrimi, me institucione  
jashtë vendit:**

1. Marrëveshje me Akademinë e Shkencave Hungarisë. Mund të nënshkruhet në një veprimtari kushtuar 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve, pranuar parimisht;

2. Marrëveshje me Akademinë e Shkencave të Ukrainës. Teksti i redaktuar i variantit të dorëzuar nga Ambasada gati për t'u dërguar;
3. Marrëveshje me Akademinë e Shkencave të Republikës Çeke. Është rënë dakord në parim gjatë vizitës së Ambasadorit, hapi i radhës është dërgimi i një propozimi kuadër nga ana jonë;
4. Marrëveshje me Akademinë e Shkencave të Kroacisë, e pranuar nga të dyja palët, mbetur pa nënshkruar për shkak të situatës pandemike;
5. Marrëveshje me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut, pranuar nga të dyja palët bashkë me protokollin qysh në vitin 2020, mbetur pa nënshkruar për shkak të ndryshimeve në Kryesi;
6. Marrëveshje me Akademinë e Shkencave të Bullgarisë (përtëritje marrëveshjeje), rënë dakord për t'u nënshkruar në festimet e përvjetorit jubilar të themelimit të saj, që nuk u bë për shkak të pandemisë;
7. Marrëveshje me Akademinë e Shkencave të Greqisë, pranuar mirëkuptimi për këtë hap gjatë vizitës së Ambasadores.

### **III. Marrëveshje ndërakademike ose ndëruniversitare të miratuara dhe të nënshkruara me institucione jashtë vendit:**

1. Marrëveshje me Universitetin e Korçës *Fan Noli*: realizuar katër bashkëpunime gjatë vitit 2021;
2. Marrëveshje me Universitetin e Vlorës *Ismail Qemali*: realizuar dy bashkëpunime gjatë vitit 2021;
3. Marrëveshje me Universitetin e Sporteve;
4. Marrëveshje me Universitetin e Mjekësisë, tre bashkëpunime;
5. Marrëveshje me Universitetin e Gjirokastrës *Eqrem Çabej*, një bashkëpunim gjatë vitit 2021;
6. Me Muzeun Historik Kombëtar, një bashkëpunim;
7. Me Institutin Kombëtar të Sociologjisë, një bashkëpunim;
8. Me Institutin e Historisë Ushtarake, një bashkëpunim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
Kryesia

**Pasqyrë përmbledhëse e ushtrimit buxhetor 2021  
sipas zërave themelorë<sup>1</sup>**

**I. Parashikimi vjetor**

<b>Nr.</b>	<b>Zërat</b>	<b>Buxheti 2021</b>
1.	Paga	30.000.000
2.	Sigurime shoqërore e shëndetsore	4.500.000
3.	Pagesa për tituj akademikë	30.000.000
	<b>Paga, pagesa dhe sigurime</b>	<b>64.500.000</b>
4	Shpenzime operative	50.050.000
5	Bashkëpunimi me Kosovën	1.000.000
6	Kuota antarësie në organizma ndërkombëtarë	400.000
7	Investime	1.000.000
	<b>Shpenzimet në tërësi</b>	<b>52.450.000</b>
	<b>Buxheti 2021</b>	<b>116.950.000</b>

<sup>1</sup> Bashkëngjitet raporti analitik vjetor i komentuar i sektorit të financës.

## II. Ndryshimet në zërat e buxhetit gjatë vitit

Nr.	Zërat	Parashikuar	Shtesë me VKM	Ndryshime me shkresën nr. 15318 datë 29 tetor	Fond i veçantë	Ndryshuar
1.	Pagat	30.000.000	-----	- 5.500.000	-----	24.550.000
2.	Sigurime	4.500.000	-----	- 550.000	-----	3.950.000
3.	Shpërblim për titull	30.000.000	-----	- 1.650.000	-----	28.484.340
4.	Shpenzime operative	50.050.000	-----	7.500.000	-----	57.550.000
5.	Me Kosovën	1.000.000	-----	-----	-----	1.000.000
6.	Kuota anëtarësie	400.000	-----	+ 200.000	-----	600.000
7.	Investime	1.000.000	-----	-----	-----	1.000.000
8.	Projektet në albanologji	-----	96.000.000	-----	-----	96.000.000
9.	Logjistikë	-----	4.000.000	-----	-----	4.000.000
		116.950.000	100.000.000	-----	-----	116.950.000
<b>Realizimi i buxhetit</b>			<b>Buxheti 2022</b>		<b>97 për qind</b>	
			<b>Buxheti shtesë</b>		<b>10 për qind</b>	



### III. Buxheti faktik në zëra në fund të vitit 2021

Nr.	Shpenzimet faktike në zëra	Parashikuar	Realizuar	Ndryshime
1.	Paga	24.500.000	24.500.000	-----
2.	Sigurime shoqërore e shëndetësore	3.950.000	3.949.426	574
3.	Pagesa për tituj akademikë	28.484.340	28.274.109	210.231
4.	Konferenca dhe aktivitete të tjera	5.000.000	4.378.513	621.487
5.	Studime e projekte	7.790.000	7.360.772	429.228
5.1.	Projekti i njësisë <i>Biotech+nanotech</i>	-----	6.336.444	-----
5.2.	Projekti i njësisë <i>Arkeo-Bylis</i>	-----	1.024.328	-----
6.	Kuvendi i albanologjisë + <i>NanoAlb</i>	10.000.000	8.920.039	1.079.961
6.1	Konferenca e nanoteknologjisë	-----	2.944.642	-----
6.2	Kuvendi i albanologjisë	-----	5.975.397	-----
7.	Pagesa komisioneve të përhershme	1.820.000	1.667.450	152.550

<b>8.</b>	<b>Njësitë e përkohshme</b>	<b>1.150.000</b>	<b>1.121.147</b>	<b>28.853</b>
<b>9.</b>	<b>Botimet</b>	<b>3.110.000</b>	<b>3.108.600</b>	<b>1.400</b>
<b>10.</b>	<b>Honorare, të drejta autoriale (reçensa, botimi i revistave)</b>	<b>8.200.000</b>	<b>8.150.891</b>	<b>49.109</b>
<b>11.</b>	<b>Honorare për pjesëmarrje me kumtime në konferenca</b>	<b>4.400.000</b>	<b>3.978.910</b>	<b>421.090</b>
<b>12.</b>	<b>Përkthim i revistës SA (4 numra)</b>	<b>1.300.000</b>	<b>1.260.358</b>	<b>39.642</b>
<b>13.</b>	<b>Konkursi ndërkombëtar në albanologji</b>	<b>1.500.000</b>	<b>1.452.500</b>	<b>47.500</b>
<b>14.</b>	<b>Shpenzime administrative</b>	<b>14.280.000</b>	<b>13.981.800</b>	<b>298.200</b>
<b>15.</b>	<b>Anëtarësime</b>	<b>600.000</b>	<b>599.887</b>	<b>113</b>
<b>16.</b>	<b>Investimet libra dhe pajisje</b>	<b>1.000.000</b>	<b>978.126</b>	<b>21.874</b>
	<b>Shpenzimet në tërësi</b>	<b>117.084.340</b>	<b>113.682.528</b>	<b>3.401.812</b>
	<b>Në përqindje</b>	<b>100 për qind</b>	<b>97 për qind</b>	



AKADEMIA E SHKENCËVE E SHQIPËRISË

SEKSIONI I SHKENCËVE NATYRËRE DHE TEKNIKE dhe NJËSIA E GJEOFIZIKËS DHE E SIZMOLOGJISË  
organizojnë

S I M P O Z I U M S O L E M N  
JETA DHE VEPRA E AKAD. EDUARD SULSTAROVËS  
DHE PROF. BETIM MUÇOS



Akad. Eduard Sulstarova



Prof. Betim Muço

Kumtues në këtë simpozium do të jenë kolegë, miq, si dhe familjarë të këtyre dy figurave të shquara  
Prof. Shyqyri Aliaj, dr. Arben Pitarka, prof. Siasi Koçiu, prof. Llambro Duni, znj. Natasha Lako, prof. Dëfrim Shkupfi,  
prof. Niko Pojani, prof. Rexhep Koçi, prof. asoc. Ylber Muçeku, znj. Marta Muço, znj. Alma Sulstarova

Veprimtaria do të zhvillohet me pjesëmarrje të kufizuar në sallën "Aleks Buda", Akademia e Shkencave dhe online në linkun:  
<https://us02web.zoom.us/j/86327631629?pwd=YnEwWnBibmdzNWxtcHNNRklnTkppOT09>



## Simpozium “Quo Vadis Humanitas”

*Frymëzuar nga leksioni i famshëm i Erwin Schrödinger, “Çfarë është jeta?”, mbajtur në Trinity College, Dublin, Irlandë*

Organizatorë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Fondacioni “Henrietta Leavitt”

Seria e aktiviteteve “Shkenca pranë publikut” / Promovimi i librit “Çfarë është jeta?”

### Programi

#### E premte, 5 shkurt

- 10.15 - 10.30 Regjistrimi. Të gjithë folësit janë të pranishëm në platformën digjitale (për folësit në Shqipëri, kërkohet prania e tyre fizike në sallën e Akademisë ku do të mbahet simpoziumi, të paktën 15 minuta përpara orarit që kanë në program).
- 10.30 - 10.35 *Mirëseardhja* Prof. Skënder Gjinushi, Kryetar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (për t'u konfirmuar).
- 10.35 – 11.00 *Paraqitje e përgjithshme / nga paradigma e vjetër dhe ekzistuese, në një të re dhe sfiduese - revolucionin shkencor që frymëzoi Erwin Schrödinger / prezantimi i botimit, në gjuhën shqip, të librit “Çfarë është jeta?”* Dr. Valbona Nathanaili, Fondacioni “Henrietta Leavitt”.
- 11.00 - 11.20 *Erwin Schrödinger – Figurë e shquar e Fizikës.* Akad. Emeritus Florian Vila, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Prof. dr. Fatos Ylli, Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar.
- 11.20 - 11.40 *Bukuria dhe misteret e mekanikës kuantike.* Prof. Jean-Louis Basdevant, Ecole Polytechnique, Francë (on-line) dhe Akad.Asoc. Mimoza Hafizi, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- 11.40 - 12.00 *Jeta në pikëprerjen e fizikës dhe biologjisë.* Prof. Endrit Kullaj, Universiteti Bujqësor.
- 12.00 - 12.20 *Qasja ndaj teknologjisë thotë shumë për personalitetin tënd!* Dr. Julinda Stefa, Talend, Paris, France (pas një periudhe 10-vjeçare si Prof. Asoc. pranë Departamentit të Shkencave Kompjuterike, Universiteti “La Sapienza”, Romë, Itali).
- 12.20 – 12.40 *Reflektimi i ideve të Schrödinger-it në Biologjinë Molekulare.* Akad. Ilia Mikerezi, Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- 12.40 – 13.00 *Pyetja e radhës e Schrödinger-it: Si do të jetë jeta?* Prof. Steve Fuller, Universiteti i Warwick-ut, Angli (on-line).
- 13.00 – 13.20 *Diskutime në panel. Pyetje dhe përgjigje* Prof. Steve Fuller, Prof. Halil Sykja, Akad. Asoc. Mimoza Hafizi, Dr. Valbona Nathanaili (pyetjet për folësit mund të fillojnë të depozitohen në adresën elektronike [bonanath@hotmail.com](mailto:bonanath@hotmail.com)).



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

# Ismail Kadare

## Shkrimtar shqiptar në letërsinë botërore

Veprimtari shkencore në nderim të 85-vjetorit të lindjes  
së akademikut Ismail Kadare

1. Fjala e hapjes nga Kryetari i Akademisë akad. **Skënder Gjinushi**;
2. **Pirro Misha**, *Kadare në letërsinë europiane dhe botërore*;
3. **Bashkim Kuçuku**, “Kadareja në kritikën botërore”, një paraqitje enciklopedike e ndërkombëtarizimit të veprës së shkrimtarit shqiptar: paraqitje e botimit të dy vëllimeve të para (“Kadareja në kritikën franceze”);
4. Njoftimi për rikandidimin e shkrimtarit Ismail Kadare për çmimin Nobel në letërsi, nga akad. **Skënder Gjinushi**;
4. Hapja e ekspozitës fotografike me foto dhe dëshmi që lidhen me momente kyçe të jetës së shkrimtarit, përgatitur nga **Roland Tasho**.  
Mbyllja e veprimtarisë.





KUVENDI I SHQIPËRISË



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË



**KONFERENCË SHKENCORE**

**PANDEMIA DHE RIMËKËMBJA: STRATEGJITË E PËRBALLJES  
